



Sahare Reçica-Havolli

QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE PËR ZBATIMIN
E FILOZOFISË SË GJITHËPËRFSHIRJES NË
INSTITUCIONET ARSIMORE NË KOSOVË

Prishtinë, 2016

Sahare Reçica-Havolli

**QËNDRIMET E MËSIMDHËNËSVE PËR
ZBATIMIN E FILOZOFISË SË GJITHËPËRFSHIRJES
NË INSTITUCIONET ARSIMORE NË KOSOVË**

Prishtinë, 2016

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autore

Sahare Reçica-Havolli

Redaktor përgjegjës

M. sc. Ismet Potera

Recensentë

Prof. dr. Demë Hoti

M. sc. Avdyl Kastrati

Ekipi hulumtues

Sahare Reçica-Havolli

Skender Mekolli

Lektor

Syhejl Havolli

Përgatitja teknike

Skender Mekolli

Përmbajtja

Abstrakt	5
ATTITUDES OF TEACHERS FOR IMPLEMENTATION OF THE PHILOSOPHY OF INCLUSION IN EDUCATIONAL INSTITUTIONS IN KOSOVO	7
1. HYRJE.....	9
2. KONTEKSTI TEORIK	10
2.1. Gjithëpërfshirja – parim në politikat arsimore të Kosovës	10
2.2. Çka janë qëndrimet.....	12
2.3. Qëndrimet e mësimitdhënësve – faktor i rëndësishëm për qasje gjithëpërfshirëse në klasë.....	14
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	17
3.1. Qëllimi i hulumtimit	17
3.2. Objektivat e hulumtimit	17
3.3. Objekti dhe rëndësia e hulumtimit.....	18
3.4. Hipoteza e hulumtimit	18
3.5. Modeli i hulumtimit.....	18
3.6. Popullacioni dhe mostra	19
3.7. Metodot dhe instrumentet e hulumtimit.....	20
3.8. Procedura e mbledhjes së të dhënave	21
3.9. Përpunimi i të dhënave	22
4. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI I TYRE.....	23
4.1. Rezultatet e hulumtimit me mësimitdhënës të shkollave	23
4.1.1. Të dhënat e përgjithshme të mësimitdhënësve.....	24

4.1.2.	Qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes	29
4.2.	Rezultatet e hulumtimit me drejtorë të shkollave	47
4.3.	Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënësit mbështetës	54
5.	ANALIZA E REZULTATEVE DHE KRAHASIMI I TYRE	67
5.1.	Ndikimi i disa faktorëve personal në qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes	68
5.1.1.	Ndikimi i gjinisë në qëndrimet e mësimdhënësve.	
5.1.2.	Ndikimi i moshës..	70
5.1.3.	Ndikimi i përvojës së punës në arsim	73
5.1.4.	Ndikimi i përvojës së punës në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta brenda klasës	75
5.1.5.	Ndikimii trajnimeve në programet për gjithëpërfshirje	78
5.1.6.	Ndikimi i gjendjes aktuale.	80
5.1.7.	Ndikimi i vendit	84
5.1.8.	Ndikimi i mbështetjes së mësimdhënësve:	85
5.2.	Gjetjet e përgjithshme	87
6.	PËRFUNDIM	91
7.	REKOMANDIME	94
	LITERATURA	98

Abstrakt

Duke u bazuar në faktin se zbatimi i politikave arsimore në klasë, varet kryesisht nga mësimdhënësit, identifikimi i qëndrimeve të mësimdhënësve - si prirje për qasje gjithëpërfshirëse në klasë, është i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Ky studim ka për qëllim të identifikojë qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes në institucionet arsimore në Kosovë.

Popullacion i këtij hulumtimi janë mësimdhënësit e klasave 1-9 dhe drejtorët e shkollave, gjegjësisht mësimdhënësit mbështetës në shkollat e zakonshme dhe shkollat „gjithëpërfshirëse” nga të gjitha rajonet e Kosovës. Ndërsa, mostrën e hulumtimit e përbëjnë: 591 mësimdhënës, 14 drejtorë shkollash dhe 13 mësimdhënës mbështetës, të përzgjedhur me metodë rasti, sipas kriterëve të përcaktuara të hulumtimit. Bazuar në përfshirjen e mostrës, rezultatet e hulumtimit mund të përgjithësohen në nivel vendi.

Për realizimin e këtij hulumtimi janë përdorur pyetësorë për mësimdhënësit, ndërsa intervista për drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit mbështetës, të cilët janë deklaruar rreth qëndrimeve të mësimdhënësve për gjithëpërfshirjen, në shkollat në të cilat ata punojnë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se hipoteza „mësimdhënësit në Kosovë kanë qëndrime negative për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes në institucionet arsimore” nuk është e qëndrueshme. Sipas gjetjeve, mësimdhënësit, bazuar në qëndrimet e tyre mund të grupohen: mësimdhënës me qëndrime

pozitive, mësimdhënës me qëndrime negative dhe mësimdhënës me qëndrime të përziera, e që është edhe grupi më i madh.

Po ashtu, janë identifikuar edhe faktorët që mund të ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve. Sipas gjetjeve, mosha më e vjetër e cila ndërlidhet edhe me përvojën e punës dhe (mos) përfshirjen në zhvillim profesional, është faktori më ndikues në qëndrimet negative të mësimdhënësve.

Mbështetja institucionale, gjinia, vendi, janë identifikuar si faktorë shumë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në grupin e mësimdhënësve me qëndrime të përziera. Supozohet se cilësitë e personalitetit si faktorë me ndikim, por të cilët nuk kanë qenë pjesë e këtij studimi, mund të jenë ndikues për fuqizimin e qëndrimeve pozitive për grupin e mësimdhënësve, të cilët përkrahin gjithëpërfshirjen.

Mbështetja sa më e fuqishme për mësimdhënësit nga institucionet relevante, është ndër rekomandimet kryesore për stimulimin e mësimdhënësve dhe ngritjen e nivelit pozitiv të qëndrimeve të mësimdhënësve – si prirje për qasje gjithëpërfshirëse.

Fjalët kyçe: arsim, faktorë, gjithëpërfshirës, mësimdhënës, nxënës, qëndrime,

ATTITUDES OF TEACHERS FOR IMPLEMENTATION OF THE PHILOSOPHY OF INCLUSION IN EDUCATIONAL INSTITUTIONS IN KOSOVO

Abstract

Based on the fact that the implementation of educational policies in the classroom depends mainly on teachers, identifying of teachers attitudes - as the trend for a comprehensive approach in the classroom, it is important for the further development of this process.

The study has the goal of identifying attitudes of teachers for implementation of philosophy of inclusive education in Kosovo Institutions.

Population of this research were teachers of 1-9 grade and principals or support teachers in inclusive schools and comprehensive schools from all regions of Kosovo. While the survey sample consisted of: 591 teachers, 14 principals and 13 teachers supporting the case method selected according to the criteria defined by research. Based on sample inclusion, research results can be generalized nationally.

To realize this research were used questionnaires for teachers and principals interviews and supportive teachers, who stated about the attitudes of teachers for inclusion in schools in which they work.

Research results show that the hypothesis,, teachers in Kosovo have negative attitudes for inclusion 'is not sustainable. According to the findings, teachers, based on their attitudes can

be grouped, teachers with positive attitudes, negative attitudes and teachers with teaching mixed attitudes, which is also the largest group.

Also they identified the factors that may affect attitudes of teachers. According to the findings, older ages, which is associated with the work experience and (non) involvement in professional development, is the most influential factor in negative attitudes of teachers

The institutional support, gender, country, have been identified as very important factors that may affect the group of teachers with mixed views. It is assumed that the qualities of personality as influential factors, but who were not part of this study, can be influential to strengthen positive attitudes for the group of teachers who support inclusion.

As powerful support for teachers from relevant institutions is key for stimulating the recommendations of teachers and raising the level of teachers' positive attitudes - as the trend for a comprehensive approach.

Key words: education, factors, inclusive, teachers, students, attitudes.

1. HYRJE

Hulumtimi është përqendruar në fushën e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë - si proces i ri që rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila mbështetet në marrëveshjet ndërkombëtare për zbatimin e konventave mbi barazinë dhe të drejtat e të gjithë njerëzve pa dallim (neni 22). Për fushën e arsimit - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në Kosovë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për realizimin e këtyre objektivave të synuara shtetërore duke zhvilluar politikat arsimore. Në këtë drejtim, MASHT ka hartuar dhe miratuar ligje dhe akte nënligjore, strategji dhe dokumente të tjera përcjellëse që rrjedhin nga to. Të gjitha këto dokumente synojnë regjistrimin, vijueshmërinë dhe zhvillimin e potencialeve të të gjithë nxënësve pa dallim aftësie apo etnie – zbatimin e gjithëpërfshirjes në shkolla. Mbi këtë bazë janë ndërmarrë edhe disa hapa të rëndësishëm për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla - klasa të rregullta. Në kuadër të aktiviteteve për realizimin e këtij misioni, janë organizuar dhe realizuar trajnime për personelin e shkollave dhe fushata vetëdijesuese për t'i përgatitur dhe sensibilizuar ato për pranimin e të gjithë fëmijëve, pa dallim. Po ashtu, disa shkolla kanë punësuar mësime mbështetëse brenda shkollës (MASHT, UA 24/2014) ndërsa shkollat e tjera të cilat përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, pretendohet se mbështeten nga mësime mbështetëse udhëtues-staf i qendrave burimore në të gjithë rajonin e Kosovës (MASHT, UA 23/2013), varësisht nga zonat që ato i mbulojnë.

Për realizimin e plotë të politikave arsimore, nevojitet gatishmëri nga ana e mësimeve – mendim pozitiv, vullnet dhe dëshirë, sepse mësuesi është personi kyç i cili duhet ta zbatojë gjithëpërfshirjen në procesin mësimor – të pranojë dallimet e nxënësve, të përshtat qasjen dhe metodologjinë. Se çfarë qëndrimesh kanë mësuesit rreth këtij procesi, në popullatë po qarkullojnë opinione të ndryshme, por nuk ka të dhëna se një hulumtim i tillë është kryer në Kosovë. Andaj, identifikimi i qëndrimeve të mësimeve si një faktor kyç, shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të arsimit gjithëpërfshirës, është parë i nevojshëm për IPK.

2. KONTEKSTI TEORIK

2.1. Gjithëpërfshirja – parim në politikat arsimore të Kosovës

Gjithëpërfshirja si filozofi e re, e ka bazën në Konventat dhe dokumentet ndërkombëtare të cilat mbështeten në barazinë dhe të drejtat e të gjithëve, pa dallim, për jetë dhe mirëqenie. Në parimin e gjithëpërfshirjes janë orientuar politikat arsimore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë. Bazuar në këtë parim, janë hartuar edhe Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2007-2017, Ligji për Arsimin Parauniversitar 2011, Plani Strategjik për Arsimin Parauniversitar 2010- 2016 dhe Korniza e Kurrikulës së Kosovës 2011. Ndërsa, për specifikat e grupeve më të marginalizuara që në Kosovë konsiderohen personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas, janë hartuar edhe udhëzime administrative dhe

strategji të veçanta të cilat sigurojnë dhe rregullojnë mundësitë ekzistuese për plotësimin e nevojave të tyre në sistemin arsimor.

Zbatimi në praktikë i këtyre dokumenteve ka rezultuar me disa reforma në arsim, në kuadër të së cilave edhe në arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Prioritetet e MASHT-it për përfshirjen e të gjithëve, pa dallim në arsim, kanë rezultuar me rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të komuniteteve pakicë në shkolla. Nga një sistem i ndarë i arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore - vetëm në shkolla speciale apo klasa të bashkangjitura, tani ato janë transformuar në qendra burimore dhe dhoma të burimeve, që kanë për detyrë – përveç arsimimit brenda, edhe mbështetjen e shkollave dhe klasave të cilat përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Krahas këtij transformimi, edhe shkollat e rregullta janë obliguar të pranojnë të gjithë fëmijët e zonës të cilën e mbulojnë, pa dallim aftësie apo etnie. Në këtë proces, një numër i konsiderueshëm i nxënësve me nevoja të veçanta janë përfshirë në klasa – shkolla të rregullta e po ashtu edhe numri i nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas të përfshirë, është rritur.

Përveç zbatimit të praktikave gjithëpërfshirëse, rëndësi i është kushtuar edhe zhvillimit profesional të mësimitdhënësve për realizimin e këtij procesi. Një numër i konsiderueshëm i mësimitdhënësve janë përfshirë në programe të ndryshme trajnimi për mësimitdhënie në klasa gjithëpërfshirëse.

Meqë, mësimitdhënia është një proces ndërveprues ndërmjet mësimitdhënësve dhe nxënësve, pa dyshim se përveç përgatitjes profesionale, ndikim të rëndësishëm në këtë proces ka edhe gatishmëria e mësimitdhënësit.

Ligjet të cilat janë në fuqi i detyrojnë shkollat dhe mësimdhënësit për përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim, por zhvillimi i potencialeve dhe rezultatet e arritjeve të nxënësve të përfshirë, varen kryesisht nga qëndrimet e mësimdhënësve për përfshirjen e plotë të tyre në procesin mësimor.

2.2. Çka janë qëndrimet

Koncepti i qëndrimeve në psikologjinë sociale është koncept me të cilin janë marrë shumë studiuues të fushës. Sipas shumë psikologëve, qëndrimet lidhen ngushtësisht me sjelljen, janë tregues të saj por, edhe e parashikojnë atë. „Ndryshimi i qëndrimeve devijon edhe sjelljen, prandaj njohja e tyre tek vetja dhe tek të tjerët, përpunimi dhe përshtatja me qëllimet dhe interesat e individit përcakton edhe modifikimin e sjelljes njerëzore”. (Dragoti, 2007).

Sipas kësaj teorie, qëndrimet e njerëzve orientojnë sjelljen e tyre ndaj çështjes së caktuar. Po ashtu, një definicion tjetër në psikologji përcakton se: „prirjet tona të ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve ndaj njerëzve të tjerë, objekteve ose ideve përbëjnë qëndrimet tona. Përbërësi i ndjenjës ka të bëjë me reagimet tona emocionale. Përbërësi sjellor ka të bëjë me veprimet tona të cilat bartin edhe vlerësimet që kemi. Përbërësi kognitiv ka lidhje me aspektin e të menduarit për formimin e qëndrimit “(Pettijohn, 1996). Përbërësi kognitiv mund të bazohet në argumente faktike ose në ide pa bazë të cilat mund t’i marrim nga njerëzit e tjerë, pa i analizuar ato. Përbërësi emocional mund të bazohet në përvojën personale. Por, përbërësi sjellor është i prirë nga qëndrimet tona.

Duke i analizuar përbërësit e qëndrimeve, konstatojmë se qëndrimet mësohen gjatë jetës nga informatat që mund t’i

marrim, kontaktet me të tjerët, përvojat, etj., dhe mund të kushtëzohen nga faktorë të ndryshëm veprues. Këta përbërës ndikojnë në formimin e perceptimeve, ndjenjave, mendimeve, bindjeve – qëndrimeve për sjellje të caktuar. Mirëpo, sipas psikologëve, në disa raste, qëndrimet nuk konsistojnë me sjellje, si pasojë e ndikimit të faktorëve të ndryshëm apo cilësive të personalitetit të njerëzve. Shpeshherë, njerëzit mund të kenë sjellje ndryshe nga qëndrimet, e kjo ndodh si pasojë e ndikimit më të fuqishëm të faktorëve që përcaktojnë sjelljen. P.sh. njeriu detyrohet ta kryej një punë edhe pse, në brendi ka qëndrime ndryshe, por, mënyra e veprimit ndryshon nga ajo që është e prirë nga qëndrimet. „Cila është lidhja midis asaj që jemi (brenda) dhe asaj që bëjmë (nga jashtë)? Supozimi kryesor që ka dalë i cili nënvizon shumicën e mësimeve, këshillimeve dhe mbarështimit të fëmijëve, ka qenë që bindjet dhe ndjenjat tona përcaktojnë sjelljen tonë publike. Pra, nëse duam të ndryshojmë mënyrën e veprimit të njerëzve, ne duhet të ndryshojmë zemrat dhe mendjet e tyre.” (Myers, 1999).

Sipas këtyre teorive të psikologjisë, për ndryshimin e mënyrës së veprimit të njerëzve, duhet ndryshuar mendimet, perceptimet, bindjet, vetëdijen – qëndrimet e tyre.

Pra, qëndrimet mund të ndryshohen varësisht nga ndikimi që mund të kenë faktorët e ndryshëm dhe mund të jenë: pozitive, negative apo të përziera.

Qëndrimet e njëanshme - negative ose pozitive, kanë të harmonizuar përbërësit kognitiv dhe afektiv që përcaktojnë qëndrimet, ndërsa njerëzit me qëndrime të përziera, nuk i kanë të harmonizuar këta përbërës të qëndrimeve dhe, në këto raste, ndikim të fuqishëm luajnë edhe faktorët tjerë implikues të cilët

nxisin apo shtyjnë ato, si: cilësitë e personalitetit dhe faktorët e rrethit.

Prandaj, sipas psikologëve, edhe ndryshimet në një sistem shoqëror, janë të kushtëzuara me ndryshime të qëndrimeve të njerëzve në atë shoqëri.

Bazuar në faktin se sistemi arsimor në Kosovë ka pësuar ndryshime dhe është reformuar, nga një sistem i ndarë i arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore – vetëm në shkolla apo klasa speciale, në një sistem gjithëpërfshirës – për të gjithë fëmijët pa dallim, për zbatim të suksesshëm të këtyre reformave, është i domosdoshëm edhe pranimi i këtyre risive -ndryshimi i qëndrimeve të të gjithë akterëve të involvuar në këtë proces, e në veçanti të mësimitdhënësve.

2.3. Qëndrimet e mësimitdhënësve – faktor i rëndësishëm për qasje gjithëpërfshirëse në klasë

Prirjet për qasje të caktuar ekzistojnë edhe tek mësimitdhënësit në raport me nxënësit dhe janë të lidhura ngushtë me përvojat, mendimet, njohuritë, informatat, bindjet, të cilat ndikojnë për formimin e qëndrimeve të tyre ndaj pranimi të diversitetit të nxënësve në klasë. Mënyra e perceptimit të këtyre faktorëve ka ndikim të drejtpërdrejtë për qasje adekuate, pritshmëri dhe sigurim të cilësisë së nxënësve të përfshirë.

Paragjykimet, mentaliteti shoqëror për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, sistemi i ndarë i arsimimit të tyre në shkolla apo klasa speciale, kanë ndikuar edhe tek qëndrimet e mësimitdhënësve në të kaluarën. Sistemi tradicional i arsimit tek shumë mësimitdhënës në shkolla të rregullta, ka ofruar një

komoditet gjatë procesit të mësimdhënies, duke mos iu kushtuar vëmendje të veçantë dallimeve individuale.

Gjithëpërfshirja, si parim i ri në sistemin arsimor në Kosovë, për realizim të suksesshëm kërkon ndryshim të qasjes së mësimdhënësve ndaj nxënësve.

Mësimdhënësit bashkëkohorë duhet të kenë kompetenca që t'iu përgjigjen nevojave të të gjithë nxënësve brenda klasës. Mësimdhënësit janë „motor” të këtij procesi dhe qëndrimet e tyre - si prirje për sjelljet e tyre, kushtëzojnë rezultatet e procesit të gjithëpërfshirjes në klasë. Paragjykimet e mësimdhënësve dhe përcaktimi i pritjeve për rezultatet e nxënësit, ndikon në angazhimin e tij për arritjen e atij rezultati. P.sh. nëse mësimdhënësi mendon se një nxënës me dëmtime intelektuale nuk mund të arrijë në mësim, ai nuk do të angazhohet shumë për zbulimin dhe zhvillimin e potencialeve të tij, dhe anasjelltas. Paragjykimet e mësimdhënësit mund të ndikojnë në qëndrimet e tij.

Mësimdhënësi është ai që duhet të zbatojë në praktikë parimet e arsimit gjithëpërfshirës. Mësimdhënësi është „çelës” për gjithëpërfshirje në arsim, është ai që ka për t'u përballur me një shumëllojshmëri të nxënësve në klasë. Politikat arsimore nuk mund të zbatohen pa gatishmërinë e mësimdhënësve.

Andaj, qëndrimet e mësimdhënësve si prirje për veprim, janë faktor shumë i rëndësishëm për procesin.

Në literaturën e shqyrtuar rreth këtij problemi, qëndrimet e mësimdhënësve janë faktorë kyç për përfshirje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Sipas disa hulumtimeve të bëra në vende të ndryshme të botës nga studiues të ndryshëm rreth integritit, gjithëpërfshirjes, përfshirjes së fëmijëve me aftësi të

kufizuara, mësimdhënësit kanë qëndrime negative ose pozitive për procesin.

Grupi i mësimdhënësve me qëndrime negative ndaj praktikave për gjithëpërfshirje e shohin si problem përfshirjen e fëmijëve, si: sjelljen e fëmijëve, aftësitë e tyre, përshtatjen e planit mësimor dhe metodologjinë e punës, andaj shprehen se nuk mund t'i mësojnë këta fëmijë në mënyrë efektive dhe po ashtu janë shprehur se ndihen të frustruar dhe fajtorë për kohën sa i kushtohen një fëmije me aftësi të kufizuara dhe qëndrojnë larg nga grupi tjetër i fëmijëve brenda klasës (M.cassady, 2011, fq. 5).

Nga ana tjetër, grupi tjetër i mësimdhënësve të cilët shfaqin qëndrime pozitive ndaj gjithëpërfshirjes, diversitetin në klasë e konsiderojnë si pasuri. Sipas studimeve të bëra nga autorë të ndryshëm, mësimdhënësit që kanë qëndrime pozitive, janë më efektiv dhe ngritin edhe cilësinë e mësimin. Po ashtu, janë hulumtuar edhe faktorët që ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve e që mund të jenë: përvoja e punës me fëmijë me aftësi të kufizuara, zhvillimi profesional, mosha, madhësia e klasës, mbështetja e nevojshme, etj. (Chopra, 2008, fq. 9).

Meqë, procesi i përfshirjes ka filluar edhe në Kosovë, është shumë e rëndësishme edhe identifikimi i qëndrimeve të mësimdhënësve. Edhe te ne qarkullojnë opinione të ndryshme rreth qëndrimeve të mësimdhënësve për këtë proces. Edhe pse deri më tani në Kosovë nuk është bërë ndonjë hulumtim për qëndrimet e mësimdhënësve, supozohet se shumë nga ta e shohin si shqetësuese faktin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e hulumtimit përmban: qëllimin e hulumtimit, objektivat, objektin dhe rëndësinë e hulumtimit, hipotezën, llojin dhe qasjen e hulumtimit, popullacionin dhe mostrën e përfshirë në hulumtim, instrumentet dhe metodat e përdorura, procedurën e mbledhjes së të dhënave, mënyrën e përpunimit, analizës dhe krahasimit të tyre.

3.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të identifikojë dhe pasqyrojë qëndrimet e mësimitdhënësve për Arsimin Gjithëpërfshirës në Kosovë.

3.2. Objektivat e hulumtimit

Objektivat kryesore të këtij studimi janë:

- Të identifikojë qëndrimet e mësimitdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës;
- Të identifikojë faktorët të cilët ndikojnë në qëndrimet e mësimitdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës?
- Të identifikojë dallimet e qëndrimeve të mësimitdhënësve për përfshirje ndër grupet e marginalizuara?

Gjithashtu, ky studim synon të nxjerrë disa rekomandime që do t'iu shërbejnë institucioneve relevante për ndërhyrje të nevojshme.

3.3. Objekti dhe rëndësia e hulumtimit

Mësimdhënësit janë zbatuesit e politikave arsimore për gjithëpërfshirje në klasë, prandaj rezultatet e procesit të gjithëpërfshirjes varen nga qëndrimet e mësimdhënësve – si prirje për qasje gjithëpërfshirëse në klasë. Duke u bazuar në këtë fakt, identifikimi i qëndrimeve të mësimdhënësve është i rëndësishëm për ndërhyrje të nevojshme të akterëve relevantë, në zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi. Andaj, objekt i këtij hulumtimi është studimi i qëndrimeve të mësimdhënësve për Arsimin Gjithëpërfshirës në Kosovë.

3.4. Hipoteza e hulumtimit

Ekziston hipoteza se mësimdhënësit e klasave të „rregullta” në Kosovë kanë qëndrime negative për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, dhe se, me dëshirë nuk i përfshijnë ata në klasë. Kjo hipotezë pritet të vërtetohet duke kërkuar përgjigje në pyetjen se, çfarë janë qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes në institucionet arsimore në Kosovë.

3.5. Modeli i hulumtimit

Është hulumtim *përshkrues, jo eksperimental*, i cili do të nxjerr një përfundim për qëndrimet e mësimdhënësve për arsimin gjithëpërfshirës. Hulumtimi ka qasje *cilësore dhe sasiore*. Kjo qasje e përzier është përdorur sepse është konsultuar literaturë e nevojshme për konceptin e qëndrimeve, janë konsultuar hulumtime të ndryshme rreth këtij problemi dhe janë shqyrtuar dokumentet e rëndësishme të politikave arsimore të Kosovës.

Ndërsa, të dhënat nga pyetësorët janë nxjerrë me metodën statistikore përmes programit Exel-PivotTable. Rezultatet janë pasqyruar me grafike dhe tabela, janë përshkruar, analizuar dhe krahasuar ato. Po ashtu, është hulumtim *korrelacional* sepse krahason ndikimin e specifikave të variablave të pavarura si: mosha, gjinia, përvoja e punës, zhvillimi profesional, vendi, etj., në variablat e varura – qëndrimet e mësimdhënësve (mendimet, njohuritë, perceptimet, ndjenjat, etj).

3.6. Popullacioni dhe mostra

Popullacion i këtij studimi kanë qenë: mësimdhënësit e nivelit fillor dhe nivelit të mesëm të ulët, gjegjësisht, klasave nga 1–9, drejtorët e shkollave „jogjithëpërfshirëse” dhe mësimdhënësit mbështetës të shkollave „gjithëpërfshirëse”.

Që rezultatet e studimit të mund të përgjithësohen në nivel vendi, është përzgjedhë mostra përfaqësuese në bazë të këtyre kriterëve, që të përfshihen:

- Mësimdhënësit e shkollave nga vendet urbane dhe rurale – sepse supozohet se mund të ketë dallim të kulturave, kushteve, mundësive, etj.)
- Mësimdhënësit e shkollave „gjithëpërfshirëse” dhe „jogjithëpërfshirëse”, për shkak të dallimeve në mbështetje.

Duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara, nga lista e shkollave „gjithëpërfshirëse” janë përzgjedhë nga një shkollë në 13 komuna të Kosovës, duke pasur parasysh përfshirjen e të gjitha rajoneve. Po ashtu, në mënyrë rastësore nga lista e shkollave janë përzgjedhë edhe 14 shkolla, duke marrë në konsideratë vendin, që

ato të jenë në vendet urbane dhe rurale (nga 7 shkolla). Gjithsej në hulumtim janë përfshirë 27 shkolla.

Mostra e mësimdhënësve për çdo shkollë ka qenë mesatarisht rreth 25, varësisht nga numri i mësimdhënësve brenda shkollës. Në shkollat me numër më të madh të mësimdhënësve, edhe numri i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim ka qenë më i madh dhe anasjelltas. Janë përfshirë mësimdhënës të klasave nga 1-9. Numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të anketuar ishte 591 gjithsej. Përzgjedhja ishte e rastësishme dhe janë përcaktuar mësimdhënësit të cilët ishin në orarin e punës - prezent në kohën e caktuar për administrim të pyetësorit. Pyetësorët kanë qenë anonim.

Për të fuqizuar besimin për rezultatet e hulumtimit, janë intervistuar edhe 14 drejtorë të shkollave „jogjithëpërfshirëse” dhe 13 mësimdhënës mbështetës të shkollave „gjithëpërfshirëse”, të cilët e mbështesin, mentorojnë dhe monitorojnë procesin dhe janë të informuar rreth zhvillimeve brenda shkollave.

3.7. Metodatat dhe instrumentet e hulumtimit

Për mostrën e mësimdhënësve është përdorur metoda e anketës, ndërsa për drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit mbështetës është përdorur metoda e intervistës. Për të dyja këto metoda janë hartuar instrumentet - pyetësorët.

Pyetësori i anketës është përbërë nga gjithsej 30 pyetje. Në pjesën e parë të pyetësorit janë përfshirë pyetjet që japin të dhënat për mësimdhënësit si: gjinia, mosha, përvoja në arsim, përvoja me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, përgatitja profesionale,

programet e trajnimeve për gjithëpërfshirje, etj., karakteristika këto që mund të ndikojnë në qëndrimet e mësimeve. Pjesa tjetër e pyetjeve janë hartuar rreth mendimeve të tyre, ndjeshmërisë, perceptimeve, dallimeve ndër grupe të marginalizuara dhe llojeve të dëmtimeve për përfshirje në klasë. Pyetjet ishin të formuluar me dy dhe më shumë alternativa. Me qëllim të verifikimit të sinqeritetit në përgjigje, pyetjet e përafërta në pyetësor janë vendosur të shpërndara.

Ndërsa, pyetësi i intervistës për drejtor dhe mësime mbështetës ishte i përbërë nga 15 pyetje gjysmë të strukturuar. Po ashtu, edhe në pyetësorin e mësimeve, pyetjet e para të intervistës ishin për të dhënat personale të respondentëve me qëllim të informimit rreth njohurive të tyre për mësime dhe përfshirjen e nxënësve në shkollë. Një grup pyetjesh drejtoreshin rreth gjendjes aktuale të përfshirjes, ndërsa pyetjet e tjera ishin të fokusuar në nxjerrjen e informatave për qëndrimet e mësimeve në shkollat përkatëse.

3.8. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat janë mbledhur gjatë muajit prill, maj, tetor dhe nëntor 2015. Për qëllimin e hulumtimit dhe administrimit të instrumenteve janë njoftuar fillimisht drejtorët e shkollave (përmes komunikimit telefonik) dhe në marrëveshje me ta, është caktuar dita dhe koha e realizimit të instrumenteve në shkollat përkatëse. Administrimi i instrumenteve është udhëhequr nga udhëheqësi i projektit, në bashkëpunim me një hulumtues, anëtar të ekipit dhe një bashkëpunëtor nga shkolla – kryesisht nga mësime mbështetës apo drejtori. Gjatë kohës së pushimit, në sallën e mësimeve, janë takuar mësime dhe janë

informuar për qëllimin e hulumtimit. U janë dhënë udhëzimet e nevojshme për plotësimin e pyetësorëve, u janë shpërndarë pyetësorët dhe u është caktuar koha e plotësimit të tyre - një orë mësimi së bashku me pushimin (50 minuta). Pastaj secili mësimdhënës i ka dorëzuar pyetësorët e plotësuar tek ekipi hulumtues dhe kështu janë grumbulluar të gjithë pyetësorët e shpërndarë.

Intervistës u janë përgjigjur respondentët nga të gjitha shkollat e përfshira në hulumtim. Intervistat me drejtorët janë mbajtur në zyrat e tyre dhe po ashtu, intervistat me mësimdhënës mbështetës të shkollës janë mbajtur në kabinetet e tyre. Vendi i intervistës është caktuar me pëlqimin e respondentëve. Intervistat janë realizuar po ashtu nga ekipi hulumtues, janë marrë shënime dhe janë incizuar në diktafon. Intervistat kanë zgjat rreth gjysmë ore. Pas çdo realizimi shënimet e marra janë kontrolluar dhe plotësuar nga të dhënat e diktafonit. Intervistat janë realizuar në kohë, paralelisht me plotësimin e pyetësorëve nga ana e mësimdhënësve.

3.9. Përpunimi i të dhënave

Fillimisht, është krijuar baza e të dhënave në programin Exel. Janë koduar pyetësorët dhe janë nxjerrë të dhënat nga pyetësorët e anketës. Të dhënat e nxjerra janë përpunuar në programin PivoTable. Rezultatet janë prezantuar përmes grafikeve ose tabelave, janë interpretuar dhe analizuar ato. Po ashtu, edhe përgjigjet nga intervistat janë nxjerrë dhe janë interpretuar. Pastaj, është krahasuar ndikimi i variablave të pavarura – faktorëve, që është supozuar se mund kenë ndikim në variablat e varura – qëndrimet e mësimdhënësve. Për të fuqizuar besueshmërinë e

hulumtimit, po ashtu, janë krahasuar edhe përgjigjet e mësimit me ato të drejtorëve të shkollave dhe mësimit mbështetës.

4. REZULTATET E HULUMTIMIT DHE INTERPRETIMI I TYRE

Rezultatet e hulumtimit përfshijnë të dhënat nga instrumentet e hulumtimit me mësimit, drejtorë dhe mësimit mbështetës të shkollave. Rezultatet do të pasqyrohen të ndara sipas instrumenteve të hulumtimit.

4.1. Rezultatet e hulumtimit me mësimit të shkollave

Hulumtimi me mostrën e mësimit është realizuar përmes pyetësorëve, me gjithsej 591 mësimit të nivelet 1 dhe 2, përkatësisht nga klasa 1-9. Numri i shkollave të përfshira në hulumtim ishte 27, me shtrirje në 22 komuna të të gjitha rajoneve të Kosovës. Nga ky numër, 13 shkolla janë përzgjedhë nga lista e shkollave „gjithëpërfshirëse”¹ të MASHT dhe 14 shkolla jashtë kësaj liste, por nga regjistri i shkollave të rregullta „jogjithëpërfshirëse”², në vendet urbane dhe rurale (shih listën e shkollave në pjesën shtesë të punimit).

¹Sqarim: MASHT, gjegjësisht departamenti për Arsim Special posedon një listë të shkollave të ashtuquajtura „gjithëpërfshirëse” në të cilat janë përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe janë punësuar mësimit mbështetës.

²Sqarim: shkolla të cilat nuk janë në listën e lartëcekur.


Sipas disa hulumtimeve të realizuara në vende të ndryshme ndërkombëtare, karakteristikat personale të mësimit si: shkolla në të cilën punojnë, vendi, niveli, gjinia, mosha, përgatitja shkollore, përvoja e punës në arsim, etj. janë faktorë që mund të ndikojnë në qëndrimet e mësimit³. Është konsideruar se këta faktorë mund të kenë ndikim edhe tek mësimit tanë. Por, për shkak të specifikave zhvillimore të vendit tonë, janë identifikuar edhe faktorë tjerë me ndikim që mund të jenë: përvoja në gjithpërfshirje brenda klasës, programet e trajnimit për gjithpërfshirje, vendi (urban apo rural) në të cilin gjendet shkolla, statuti i shkollës („gjithpërfshirëse” ose „jo gjithpërfshirëse”), etj.

Në pjesën e parë të pyetësorit janë shtruar pyetje për këto të dhëna të cilat do të prezantohen në këtë pjesë të punimit, ndërsa analiza dhe krahasimi i këtyre variablave të pavarura dhe ndikimi i tyre në variablat e varura që përbëjnë qëndrimet e mësimit do të paraqitet në kapitullin vijues të punimit (analiza dhe krahasimi i rezultateve).

4.1.1. Të dhënat e përgjithshme të mësimit


- *Gjinia* e mësimit për shkak të natyrës së specifikave është konsideruar faktor i brendshëm që mund të ndikojë në qëndrimet e tyre për gjithpërfshirje. Sipas të dhënave, 72.73% nga mësimit e përfshirë në hulumtim janë femra, ndërsa 27.27% janë meshkuj. Të dhënat tregojnë se nga respondentët e përfshirë në hulumtim rreth $\frac{3}{4}$ janë femra.

³<http://www.tandfonline.com/loi/rejs20>



Grafiku 1. Gjinia e mësimdhënësve


- *Mosha* e mësimdhënësve: janë kategorizuar grupmosha brenda dekadave, duke u bazuar në moshën prej kur një mësimdhënës mund të fillojë punën. Grafiku në vijim pasqyron përqindjen e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim, sipas grupmoshave:



Grafiku 2. Mësimdhënësit sipas grupmoshave

Nga grafiku vërehet se në shkollat e përfshira në hulumtim mbizotëron mosha e mesme, të cilët pritet të jenë pjesë produktive e proceseve në të ardhmen.

- *Përgatitja shkollore*: Nga grafiku në vijim vërehet se mbi 68% të mësimitdhënësve kanë përgatitje superiore profesionale dhe 2.75% e mësimitdhënësve kanë të kryer vetëm shkollën normale.




Grafiku 3. Përgatitja shkollore e mësimitdhënësve

*) Tjetër- Shkollë Normale

- *Përvoja e punës në arsim*, si proces i mundësisë për njohje të dallimeve të personaliteteve, aftësive dhe shkathtësive të ndryshme të nxënësve, ndikon në pasurimin e njohjes së proceseve në punë dhe formimin e qëndrimeve të mësimitdhënësve.


Përvoja pesëvjeçare është konsideruar si përvojë solide që ndikon në pjekurinë profesionale. Bazuar në këtë, grupet e mësimitdhënësve sipas përvojës janë paraqitur në grafikun në vijim.



Grafiku 4. Përvoja e punës së mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim


- *Përvoja në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore brenda klasës është një tregues i rëndësishëm i besueshmërisë së të dhënave të hulumtimit për qëndrimet e mësimdhënësve. Përvoja e punës mundëson njohjen e procesit të gjithëpërfshirjes, perceptimin dhe krijimin e mendimit për procesin e gjithëpërfshirjes, e që, reflekton edhe në prirjet për sjelljet e tyre dhe rezultatet e këtij procesi.*

Meqë, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasa të rregullta është një proces i ri në Kosovë, jo të gjithë mësimdhënësit kanë pasur rastin të kenë këtë përvojë (grafiku në vijim). Të gjeturat tregojnë se mbi 34% e mësimdhënësve nuk kanë asnjë vit përvojë përfshirëse.



Grafiku 5. Përvoja e mësimdhënësve në përfshirje të FNV sipas viteve

- *Zhvillim profesional* në programet për gjithëpërfshirje: Bazuar në faktin se gjatë shkollimit të tyre shumë mësimdhënës nuk kanë pasur mundësinë të aftësohen për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe qasjen gjithëpërfshirëse, zhvillimet në fushën e arsimit, reformimi i sistemit arsimor, kanë kushtëzuar edhe organizimin e programeve të trajnimit për zhvillim profesional për nevojat e mësimdhënësve. Mirëpo, sipas të gjeturave, këto programe nuk i kanë ndjekur shumica e mësimdhënësve. Programet më të ndjekura për gjithëpërfshirje sipas mësimdhënësve, janë të pasqyruara në grafikun në vijim:



Grafiku 6. Programet për gjithëpërfshirje të ndjekura nga mësimdhënësit

Nga të tjera programe të ndjekura në masë më të vogël, respondentët deklarojnë trajnimet nga organizata Save the Children, KKK, Hap pas hapi, programe psiko-sociale, kursin e shkrim-leximit, vlerësimi formativ, vështirësitë në të nxënë, kursi i matematikës, etj., që të gjitha përbëjnë 19,18%.


- Po ashtu, *gjendja aktuale në klasë* mund të ndikojë në shfaqjen e qëndrimeve më të formuara të mësimdhënësve. Duke analizuar nga ky këndvështrim, u është bërë pyetja mësimdhënësve se a keni nxënës me nevoja të veçanta në klasë. Të dhënat tregojnë se 35.5% e mësimdhënësve kanë të përfshirë nxënës me nevoja të veçanta në klasat e tyre, ndërsa 53.2% nuk kanë nxënës të përfshirë në klasat e tyre. 11.1% nuk janë deklaruar.

4.1.2. Qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes

Për të kuptuar në mënyrë sa më reale mendimet, njohjet, ndjenjat, sjelljet - qëndrimet e mësimdhënësve, me qëllim të ikjes nga


ndikimi i përgjigjeve paraprake në përgjigjet e pyetjeve në vazhdimësi, pyetjet në pyetësor kanë qenë të shpërndara, jo të grupuara apo të radhitura sipas objektivave të caktuara.

Mësimdhënësve u është bërë pyetja *se çka mendojnë ata, ku duhet të arsimohen fëmijët me aftësi të kufizuara*. Nga të dhënat e përgjithshme, afër 52% e mësimdhënësve mendojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të arsimohen në klasa të rregullta, ndërsa mbi 47% mendojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të arsimohen në klasa (shkolla) të veçanta. Vetëm një përqindje shumë e vogël e mësimdhënësve mendojnë se duhet të përcjellin arsimim të kombinuar: një pjesë të orarit në klasa të rregullta dhe një pjesë, në klasa të veçanta.



Grafiku 7. Mendimet e mësimdhënësve për përfshirjen e fëmijëve me AK në shkollë

- Pyetja në vazhdim ka të bëjë me shprehjen e mendimit të mësimdhënësve për gatishmërinë e shkollës për gjithëpërfshirje. Sipas të dhënave, mbi 76% e mësimdhënësve mendojnë se shkollat e tyre janë të gatshme për gjithëpërfshirje, ndërsa rreth 24% prej tyre mendojnë se shkollat në të cilat ata punojnë, nuk janë të gatshme.




Grafiku 8. Mendimet e mësimeve për gatishmërinë e shkollave për gjithëpërfshirje

- Një tregues shumë i rëndësishëm për qëndrimet e mësimeve për gjithëpërfshirje është edhe faktori i suksesit që i shtyn ata për t'i pranuar fëmijët me nevojë të veçanta arsimore në klasat e tyre, sepse hulumtimet e shumta kanë treguar se nëse mësuesi e pranon me dëshirë fëmijën në klasë, edhe pritshmëria për sukses është më e lartë, dhe anasjelltas. Për t'i nxjerr këto rezultate, është dedikuar pyetja: *fëmijët me nevojë të veçanta në klasën tuaj i pranoi* - ka pasur katër opsione për përgjigje: *me dëshirë* (që nënkupton vullnetin, ndjeshmërinë, përgjegjësinë); *nga përgjegjësia* (ndjenja shpirtërore dhe obligimi shoqëror); *nga keqardhja* (ndjenja shpirtërore); dhe *nuk do t'i pranoja fare* (mungojnë atributet pozitive).


Në këtë pyetje, mësuesit kanë dhënë këto përgjigje: me dëshirë, janë përgjigj afër 50% e mësimeve, ndërsa në shkallën më të ulët të opsioneve krahasuese – nuk do t'i pranoja

fare, janë përgjigj mbi 3% e mësimdhënësve. Grafiku në vijim pasqyron përgjigjet në këtë pyetje.




Grafiku 9. Faktorët shtytës për praniminë e FNVA në klasë

- Pyetjes: *a jeni në dijeni për llojet e aftësisë së kufizuar dhe nivelet*, mbi 70% e mësimdhënësve janë përgjigj pozitivisht, ndërsa të tjerët afër 30% janë deklaruar se nuk dinë për llojet dhe nivelet e aftësive të kufizuara.



Grafiku 10. Njohuritë e mësimdhënësve për llojet dhe nivelet e aftësive të kufizuara

- Me që, termi *gjithëpërfshirje* nënkupton përfshirjen e të gjitha grupeve të marginalizuara, pa dallim, mësimdhënësve u është drejtuar pyetja: *në klasën tuaj, më lehtë do të pranoni fëmijë me: vështirësi në të nxënë; aftësi të kufizuara; nga komunitetet; nga të gjitha grupet, pa dallim; nga asnjëri grup.* (shih përgjigjet në grafik)




Grafiku 11. Preferencat e mësimdhënësve për përfshirje sipas grupeve të marginalizuara

Sipas grafikut, mbi 54% e mësimdhënësve nuk bëjnë dallime ndër grupe të marginalizuara për përfshirje brenda klasës. Por, ata të cilët bëjnë dallime, më shumë preferojnë fëmijët me vështirësi në të nxënë. Po ashtu, 14.11% deklarohen për fëmijët e komuniteteve. Se mësimdhënësit nuk hezitojnë për pranimin e komuniteteve, deklarohen edhe drejtorët dhe mësimdhënësit mbështetës të shkollave.


- Ndërsa nga llojet e aftësisë së kufizuar, mbi 70% e mësimdhënësve përgjigjen se më lehtë do të punonin me fëmijë me dëmtime fizike, ndërsa më pak preferojnë të punojnë me fëmijë me dëmtime në të dëgjuar. Përgjigjet e

mësimdhënësve për preferencat e tyre bazuar në llojet e dëmtimeve janë pasqyruar në grafikun në vijim:




Grafiku 12. Preferencat e mësimdhënësve për përfshirje sipas llojit të dëmtimit

- *Mbështetja e mësimdhënësve në procesin e gjithëpërfshirjes është identifikuar si faktor i jashtëm shumë i rëndësishëm që mund të ketë ndikim në qëndrimet e mësimdhënësve. Shërbimi profesional i shkollës është identifikuar si mundësia më potenciale për mbështetje. Më shumë se 55% e mësimdhënësve përgjigjen se mund t'i mbështet në punë mësimdhënësi mbështetës apo gjithëpërfshirës, ndërsa mbi 38% të mësimdhënësve, për procesin e gjithëpërfshirjes, presin mbështetje nga pedagogu apo psikologu i shkollës. Vetëm 7.22% janë deklaruar se presin mbështetje nga mësimdhënësi udhëtues, ndërsa mbi 8% nuk presin mbështetje nga askush. (grafiku 13)*



Grafiku 13. Pritjet e mësimeve për mundësitë e mbështetjes

- Vetëbesimi i mësimeve është një tregues i rëndësishëm për qëndrimet e tyre. Sa ndihen ata të sigurt në brendinë e tyre të punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe se a mund të përfshijnë në klasat e tyre të gjithë nxënësit, pa dallim aftësie, këto përgjigje i paraqet grafikun në vijim:




Grafiku 14. Vetëbesimi i mësimeve për gjithëpërfshirje

Sipas të dhënave në grafik, afër 72% e mësimeve kanë vetëbesim për të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe mbi 65% e tyre mund të përfshijnë të gjithë nxënësit, pa dallim aftësie.

Për arritjen e rezultateve në procesin e gjithëpërfshirjes, është shumë i rëndësishëm edhe perceptimi për nxënësin e përfshirë nga ana e mësimeve, sepse shpeshherë mësimeve kanë paragjykimet për nxënësit e caktuar dhe pastaj, që në fillim krijohen pritje të gabuara. Për disa mësimeve, mjafton vetëm integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara në klasë dhe nuk i kushtojnë rëndësi përfshirjes së nxënësit në të gjitha aktivitetet brenda klasës.


Në pyetjen *se nxënësin me nevoja të veçanta e konsideroni vlerë apo pengesë në klasë*, afër 59% e konsiderojnë vlerë, ndërsa mbi 40% e konsiderojnë pengesë në klasë. 0,55% e mësimeve e konsiderojnë edhe vlerë, edhe pengesë.



Grafiku 15. Perceptimi i nxënësve me NVA në klasë

Në qëndrimet e mësimeve për të përfshirë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore, ndikojnë edhe faktorë tjerë të jashtëm. Ndër vështirësitë që ata potencojnë janë: numri i madh i


nxënësve në klasa, afër 82%; nuk më premtan koha për të punuar me FNV, mbi 24%; nuk di të punojë me fëmijë me NVA, 11.7%; nuk di të bëj PIA, 3.6%; nuk kam ndihmë (mbështetje) nga askush. Ndër të tjera, ata potencojnë edhe mungesën e infrastrukturës së shkollës, mentalitetin e vendit, frika se mund t'i dëmtojnë të tjerët, moshën e papërshtatshme, shkallën e dëmtimit etj.



Grafiku 16. Vështirësitë e mësimeve për përfshirje


- Disa pyetje në pyetësor u janë drejtuar mësimeve se *a janë të gatshëm* për t'i përmbushur disa kritere për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në klasë. Gatishmëria përfshinë faktorët e brendshëm të mësimit, që nënkupton se din, don, mundet, angazhohet për të arritur sukses në punë. Në këto pyetje, përgjigjet e mësimeve tregojnë gatishmëri të lartë për gjithëpërfshirje. Shumica nga ta janë deklaruar se janë të gatshëm të përshtatin planifikimin për gjithëpërfshirje, të punojnë në formë individuale, të hartojnë PIA, të bashkëpunojnë me kolegë dhe ekspertë, të kërkojnë programe specifike trajnimi, etj.

Përgjigjet për këto pyetje janë paraqitur të përmbledhura në grafikun 17



Grafiku 17. Gatishmëria e mësimeve për gjithëpërfshirje

- Në pyetjen se *si ndihen mësimeve nëse në klasë kanë fëmijë me nevojë të veçanta*, përgjigjet e tyre janë më të zbehta krahasuar me përgjigjet paraprake.




Grafiku 18. Si ndihen mësimeve me nxënës me NVA në klasë

Vetëm 20% e mësimitdhënësve japin përgjigje se ndjehen shumë mirë me nxënës me nevoja të veçanta në klasë. 53 % nga ta, thonë se ndjehen mirë por që nënkupton se janë më të rezervuar në qëndrime dhe se ka elemente edhe të pakënaqësisë brenda tyre. Mbi 26% e mësimitdhënësve ndihen jo mirë apo keq, që do të thotë se ky grup i mësimitdhënësve fëmijët me nevoja të veçanta arsimore i pranon më tepër nga detyrimi.

- Po ashtu, në pyetjen se *a do duhet të përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuara në klasa të rregullta*, 68,02% prej tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa, 29,27% janë përgjigjur me “jo”.

Shifrat e përgjigjeve në pyetjen paraprake ku mbi 26% të mësimitdhënësve ndihen jo mirë apo keq, janë të përafërta me përgjigjet në pyetjen se nxënësit me aftësi të kufizuara nuk duhet përfshirë në klasa të rregullta, që do të thotë se ky grup i mësimitdhënësve fëmijët me nevoja të veçanta arsimore i pranon më tepër nga detyrimi.

Mësimitdhënësve u është parashtruar edhe pyetja: *a do të dëshironit të jeni mësimitdhënës gjithëpërfshirës?* Sipas të gjeturave, 75.2% prej tyre dëshirojnë të jenë mësimitdhënës gjithëpërfshirës.



Grafiku 19. Dëshira për të qenë mësimegjithëpërfshirës

Sipas të dhënave, shumica e mësimegjithëpërfshirësve (mbi 70%), edhe pse janë prononcuar se dëshirojnë të jenë mësimegjithëpërfshirës, kanë shpreh arsyetimet e tyre edhe pozitive edhe negative, që nënkupton se kanë dilema duke potencuar faktorët e jashtëm si sfida të këtij procesi. Pra, kanë një përgjigje por dy arsye: edhe pozitive edhe negative.

Arsyet e dhëna për qëndrimet e tyre do të prezantohen në tabelën vijuese:

Tabela nr.1: Arsye e mësimegjithëpërfshirësve për përgjigjet e tyre

Arsyet për përgjigje pozitive	Arsyet për përgjigje negative
<ul style="list-style-type: none"> ▪ për nxënie më të lehtë të mësimit ▪ arsyeja për të mësuar nga njëri tjetri metoda produktive 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ çdo shkollë duhet të ketë klasë speciale dhe mësimegjithëpërfshirës përkatës për këtë kategori të nxënësve. ▪ është problem se të tjerët

<ul style="list-style-type: none"> ▪ aftësohet për jetën e vet ▪ ata nuk e ndiejnë veten larg shoqërisë ▪ bazuar në etikën e mësimitdhënësit ▪ të drejta të barabarta ▪ janë të mirëseardhur ▪ dëshiroj të jem mësimitdhënës gjithëpërfshirës vetëm se duhet të zvogëlohet numri i nxënësve në klasë ▪ dëshiroj të jem në shërbim të të gjithë nxënësve në klasë, pa marrë parasysh vështirësitë që kanë ata. ▪ dëshiroj t'iu përshtatem të gjithë nxënësve pa dallim ▪ dëshiroj të jem gjithëpërfshirës nëse eliminohen pengesat për punë ▪ do të doja të trajnohesha në mënyrë specifike për 	<p>mbeten mbrapa</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ fillimisht kushtet në klasë nuk janë të volitshme për gjithëpërfshirje, duke pasur parasysh numrin e madh të nxënësve, kohën e kufizuar plan-programet e stërngarkuara ▪ FNV janë pengesë në zhvillimin e orës mësimore ▪ janë pengesë në klasë sidomos fëmijët me dëmtime të rënda intelektuale ▪ jo nuk duhet të përfshihen sepse nuk mund të marrin informacione baras me të tjerët, dhe të tjerët ngecin. ▪ jo pasi nuk jam e shkolluar për atë. ▪ jo sepse duhet të intregrohen në kl. speciale ▪ jo sepse nuk janë të barabartë me fëmijët e tjerë ▪ kërkohet angazhim më i madh se me nënësit e tjerë, unë i kam kaluar disa vjet-
--	---

<p>NNV dhe praktikimin e metodave gjithëpërfshirëse</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ sepse do të kujdesesha që në klasën time të mos ketë dallime mes fëmijëve ▪ do të isha e lumtur të jepja kontributin tim në këtë drejtim ▪ do të kisha dëshirë të më mundësonin trajnime që janë të nevojshme për raste të tilla dhe kushte e hapësira të përshtatshme ku edhe FNV do të ndiheshin të sigurt ▪ duhet të kenë qasje që ta mos e ndiejnë veten të diskriminuar ▪ do të dëshiroja të jem mësimdhënëse gjithëpërfshirës nëse do të më ofroheshin kushtet si: zvogëlimi i numrit të nxënësve në klasa, sepse të tjerët mbesin mbrapa ▪ të ketë shërbime 	<p>mosha</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjithëpërfshirja nuk mund të bëhet për arsye të kushteve, përgatitjeve, trajnimeve ▪ dëmtime të shkallës së lartë ▪ ka shumë pak ekspertë dhe ka mësimdhënëse që nuk janë të njohur me vështirësitë mentale, çrregullime e vështirësi në të nxënë. ▪ duhet trajnim shtesë ▪ NVV duhet të hartohen planprograme për të punuar me këta persona me aftësi të kufizuara. ▪ Përveç orëve të shkathtësive ▪ bëjnë pengesë në klasë dhe nxënësit tjerë e humbin koncentrimin ▪ duhet durim i madh dhe kohë ▪ duhet përgatitje e veçantë ▪ duhet përkujdesje shumë e madhe si për arsimtarët,
---	---

<p>profesionale si: mës. gjithpër. pedagog, psikolog etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ duhet të kenë qasje që të mos e ndiejnë veten të diskriminuar ▪ duhet të përfshihen në klasa të rregullta me përjashtim të atyre me dëmtime të rënda intelektuale ▪ duhet t'i pranojmë se janë pjesë e jetës sonë, ▪ të socializohen me bashkëmoshatarët ▪ duhet t'iu japim dashuri dhe përkushtim ▪ e kam provuar veten në gjeneratën e kaluar, ia dola me sukses ▪ të arrijnë në jetë dhe të jenë të dobishëm për shoqërinë. ▪ edhe ata me ngecje mund të përmirësohen në një rreth të shëndoshë ▪ është e nevojshme sepse 	<p>ashtu edhe për nxënësit. Nëse ata i ndihmojmë, i diskriminojmë fëmijët normal, sepse iu japim hapësirë atyre që, në shkolla speciale do të merrnin mësim pa e penguar askënd.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ duhet punë, nuk m'i përgjigjet moshës që kam ▪ duhet punuar më shumë se me të tjerët dhe nuk premtun koha ▪ duhet të na ndihmohet për t'iu kushtuar vëmendjen e nevojshme këtyre fëmijëve, jo vetëm fjalë e formularë me plotësua. ▪ duhet të ndryshoj mentaliteti në shkollë dhe në popull. Të punosh me FNV është mund i madh, kurse rezultati është i vogël sepse ende nuk dinë të vlerësojnë as shkolla e as opinioni ▪ është vështirë, sepse për një orë nuk mund të realizohet
--	---

<p>po rritet numri çdo ditë e më shumë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ është kënaqësi të punojmë me klasë gjithëpërfshirëse, sepse kontributi i mësimdhënësit në mësimdhënie duhet të jetë i pakufizuar ▪ është mirë që në të mësohemi të punojmë me FNV ▪ gjithëpërfshirja ndihmon dhe lehtëson punën e mësimdhënësit dhe të nxënësit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies ▪ përfshirja i jep kurajë FNV, i bën të ndihen më me vlerë dhe është përvojë shumë e vlefshme për mësimdhënësin ▪ i takon secilit mësimdhënës përgjegjësia për t'u përgatitur për këtë sfidë. 	<p>me dy plane-për atë të normalitetit dhe ata me aftësi të kufizuara</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ është vështirë të punosh në formë individuale dhe duhet të ketë më shumë kohë dhe hapësirë ▪ F. me dëmtime të rënda intelektuale janë rrezik për fëmijët tjerë ▪ është ngarkesë e madhe për mua ▪ fëmijët tjerë nuk janë të vetëdijesuar për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta ▪ jam e ndjeshme në këto raste ▪ jo sepse nuk jam profesionist i këtij profili ▪ jo sepse prindërit nuk punojnë me ta ▪ ka mungesë të kushteve elementare për punë me nxënës me aftësi të kufizuar ▪ më duket se këta fëmijë duhet trajtuar dalëngadalë e
---	--

<ul style="list-style-type: none"> ▪ janë fëmijët tanë, do të ndiheshin më të barabartë, të shoqëruar ▪ konsideroj se nuk do t'i hyjë asnjërit në hak ▪ largohet frika dhe paragjykimet, kanë më shumë sukses në mësim ▪ mendoj se gjithpërfshirja e nxënësve është pozitive edhe për fëmijën edhe për tjerët, sepse adaptohen ata me ne dhe ne me ata ▪ mësimdhënia bëhet me nxënësin në qendër e jo me mësuesin në qendër ▪ besimi dhe ndjenjat për efikasitet ▪ të përmbush në aspektin emocional ▪ misioni im do të ishte i kompletuar nëse do të isha gjithpërfshirës ▪ do të mburresha ▪ se të bën një mësimdhënëse më të 	<p>në mungesë të kohës nuk mund të përfshihen dhe zbulohen aftësitë e tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ me këta nxënës kërkohet përgatitje e veçantë, hapësirë dhe ambient i cili ju përgjigjet fëmijëve, por edhe arsimtari duhet të jetë në nivel ▪ mospërgatitja e kuadrit dhe mungesa e mësuesve mbështetës ▪ në kohën dhe rrethanat që punojmë jam kundër gjithpërfshirjes (numri i stërngarkuar i nxënësve, lëvizjet e pakoordinuara të NAK pengojnë mësimin ▪ nga një nxënës shkon në dëm krejt klasa ▪ numri i madh i nxënësve nuk premtan koha t'iu plotësojmë kërkesat këtyre nxënësve ▪ nuk dëshiroj për arsye të sfidave dhe vështirësive që na dalin para vetes
---	--

<p>fortë</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ për shkaqe humanitare ▪ po është obligative dhe mund të ndjehem e lumtur ▪ po sepse e njoh punën me këta fëmijë dhe është punë dhe përgjegjësi e madhe ▪ po, vetëm në orët e shkathtësisë, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ nuk do të ndihet mirë ▪ nuk jam e gatshme dhe e kualifikuar ▪ nuk mundem me mbërriri suksesin e dëshiruar, prandaj jam kundër gjithëpërfshirjes ▪ nuk na del kohë për punë me ta në orën mësimore, kur duam t'i ndajmë pak kohë për nxënës të tjerë, bëhemi të bezdisshëm, ata pastaj bëjnë zhurmë ▪ sepse duhet përkushtim vetëm për ata, etj.
---	---

Nga arsyet për përgjigje pozitive, mësimdhënësit kryesisht potencojnë të drejtat e të gjithëve pa dallim, faktorët e etikë të profesionit të tyre që do duhej t'i kishte secili mësimdhënësi, por gjithashtu potencojnë edhe arsyet dhe vështirësitë që hasen në këtë proces. Nga arsyet për përgjigje negative, kryesisht arsyetohen në faktorët e jashtëm, por edhe ata të brendshëm, si: kushtet e shkollës, numri i madh i nxënësve në klasa, planprogramet e ngarkuara, koha në dispozicion, por potencojnë edhe përgatitjen profesionale, moshën, nivelin e dëmtimit, pengimin e nxënësve të tjerë etj.

4.2. Rezultatet e hulumtimit me drejtorë të shkollave

Drejtorët e shkollave janë konsideruar burimi i informatave për qëndrimet dhe sjelljet e mësimeve, e posaçërisht në rastet kur mungon shërbimi profesional (pedagogu apo psikologu në shkollë), pasi që janë përgjegjësit kryesor të menaxhimit të shkollave. Në këto raste, drejtorët ngarkohen edhe me mentorimin dhe monitorimin e aspektit profesional të mësimeve dhe janë në dijeni për të gjitha proceset që ndodhin në shkollë. Duke u bazuar në këto fakte, në shkollat të cilat nuk kishin këto shërbime, në hulumtim janë përfshirë drejtorët e shkollave me qëllim të marrjes së informatave për qëndrimet e mësimeve për arsimin gjithëpërfshirës. Të gjithë drejtorët e përfshirë në hulumtim janë nga shkollat e rregullta të cilat nuk gjenden në listën e shkollave gjithëpërfshirëse dhe nuk kanë të punësuar mësime mbështetës.

Pyetësi për intervistë është përbërë nga pyetje gjysmë të strukturuar dhe intervistës iu kanë përgjigjur 13 drejtorë.

Për të kuptuar nivelin e njohjes së procesit të gjithëpërfshirjes në shkollë, pyetjet e para ishin përgatitur për vetë drejtorin e shkollës. Sipas të dhënave, të gjithë drejtorët kishin përvojë të mjaftueshme (prej 5 deri 12 vite) për të dhënë vlerësime për punën e mësimeve në shkollat përkatëse dhe ishin të informuar shumë mirë për qëndrimet e mësimeve për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasë.

Meqë, deklaratimet e drejtorëve ishin të ndryshme, nuk janë paraqitur përmes tabelave apo grafikeve, por janë përshkruar

ashtu siç janë përgjigjur. Në disa raste, përgjigjet e njëjta janë grupuar, përshkruar dhe analizuar sipas të dhënave statistikore.

- *Numri i nxënësve të përfshirë në këto shkolla ishte: nga 1 deri në 200 nxënës të përfshirë, me aftësi të kufizuara dhe të komuniteteve, që do të thotë se të gjitha këto shkolla kishin praktika të gjithëpërfshirjes. 15.3% nga drejtorët kanë deklaruar se në shkollë kanë vetëm nxënës të komuniteteve dhe jo edhe me aftësi të kufizuara, 38.4% prej tyre, kanë në shkollë nxënës të përfshirë edhe nga komunitetet, por edhe me aftësi të kufizuara, ndërsa të tjerët, 46.1% shprehen se kanë të përfshirë vetëm fëmijë me aftësi të kufizuara.*
- *Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në këto shkolla, sipas respondentëve është nga 4,5 deri në 16 nxënës të përfshirë.*
- *Ndërsa numri i nxënësve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas, në shkollat të cilat mbulojnë zonat në të cilat jetojnë këto komunitete, janë nga 5,6 e deri në rreth 200 nxënës të përfshirë.*
- *Të gjithë drejtorët janë deklaruar se bëjnë përgatitje dhe plan veprimi për gjithëpërfshirje.*
- *Në pyetjen se a janë të trajnuar mësimmhënësit, 61.5% e respondentëve deklarojnë se po shumica e mësimmhënësve*

(deri në 70, 80 %), ndërsa 38.5% nga ata deklarojnë pak apo pjesërisht mësimdhënësit janë të përfshirë në trajnime.

- Ndërsa pyetjes se *a i dinë nevojat e mësimdhënësve për trajnime*, asnjëri nga ata nuk dha ndonjë përgjigje specifike, por vetëm se kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme.

- Në pyetjen rreth qëndrimeve të mësimdhënësve se *a hezitojnë t'i pranojnë fëmijët me aftësi të kufizuara, përgjigjet e tyre ishin:*
 - po, ka disponim, por nuk ka mundësi (1);
 - po, është angazhim shtesë, në fillim kanë reaguar edhe për RAE, tashti jo, në fillim edhe prindërit kanë hezituuar;
 - jo-përkundrazi, i inkurajojnë, i motivojnë, i qojnë te mjeku;
 - ekziston një lloj frike se mbesin mbrapa nxënësit e tjerë, kërkojnë asistente;
 - po, shumë - numri i madh i nxënësve në klasë bëhet barrë dhe nuk kanë mbështetje;
 - nuk hezitojnë, ndjejnë keqardhje;
 - po hezitojnë, nuk kanë qejf;

- po, sepse kemi probleme edhe me prindër, prindërit nuk e pranojnë realitetin, një prind e ka shqyer PIA-n;
- të komuniteteve nuk hezitojnë;
- po, janë të gatshëm, por numri i madh i nxënësve në klasë;
- jo, nuk hezitojnë përveç 2,3 më të vjetër;
- nuk kanë qejf, por nuk reagojnë;
- shumica hezitojnë, sidomos ata para pensionit;
- jo, nuk hezitojnë.

Nga përgjigjet e drejtorëve kuptojmë se vetëm 4,5 prej tyre kanë dhënë përgjigje pozitive se, mësimdhënësit nuk hezitojnë apo janë përshtatur me kohën. Ndërsa të tjerët deklarohen se mësimdhënësit hezitojnë, apo pjesërisht hezitojnë. Përgjigjet e tyre për mësimdhënësit me qëndrime negative, i arsyetojnë me ndikimin e kushteve, faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm.

- Në pyetjen se a janë *të gatshëm* mësimdhënësit për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të komuniteteve, përgjigjet e drejtorëve janë përafërsisht të njëjta: për komunitetet janë të gatshëm, ndërsa për fëmijët me nevoja të veçanta ka dilema, sidomos gjeneratat më të vjetra.
- Sa i përket *regjistrimit* në klasë të parë, rreth 65% e drejtorëve deklarohen se nuk ka problem, sepse kemi

parasysh barazinë në shpërndarje, ndërsa të tjerët thonë se varet sa janë trajnuar, kërkojnë t'i regjistrojnë në klasë të bashkangjitur, vetë prindërit i kërkojnë mësimdhënësit me moshë më të re, etj.

- *Vështirësitë* që i potencojnë mësimdhënësit, sipas drejtorëve janë:
 - metodologjitë e mësimdhënies;
 - nuk arrijnë shkrim - lexim, ndërsa prindërit nuk dinë t'i ndihmojnë;
 - mosbashkëpunimi i prindërve;
 - qasja, metodat, frika se ikin nga shkolla;
 - përgatitje ekstra, ikin nga ora, imitojnë fëmijët e tjerë, fjalori i tyre;
 - prishin qetësinë, vështirë për t'i mbajtur nën kontroll, mbeten të tjerët pas, etj.;
 - ambientimi, mungesa e kushteve, koha që duhet kushtuar, nuk ka asistencë, po i ndihmojmë këta e po i marrim në qafë të tjerët;
 - numri i madh i nxënësve në klasë;
 - po pritojnë të punojnë me këta fëmijë, mësimdhënësi i lë anash, nuk i fut në program, s'kanë qejf t'i kenë në klasë;

- koha në dispozicion, kanë probleme, nuk dinë me u marrë me ta, trajtim të veçantë, qasje tjetër, mësuesit nuk janë makina;
 - ana teknike, mjete didaktike, na shkon shumë letër, për teste, etj.
- Në pyetjen se a kërkojnë mësime të mbështetja për gjithëpërfshirje, drejtorët përgjigjen: 85% prej tyre deklarohen se mësime të kërkojnë mbështetja, nga kolegët, drejtori. Ata cekin mungesën e shërbimit profesional në shkollë, ndërsa 7% deklarohen, se mësime të kërkojnë mbështetja. Të tjerët deklarohen se kërkojnë pjesërisht. Disa drejtorë deklarohen: „por ka raste edhe kur dorëzohen, thonë s’di çka të bëj me të; po, kërkojnë ndihmë sepse s’dinë çka të bëj me të, do të ishte mirë që t’i grumbullojmë në klasa të veçanta, sepse i pengojnë të tjerët; po, me Handikosin, shkollë s’ka as pedagog, psikolog, mjek, asistent, laborator”, etj.
- Se mësime të janë të interesuar apo jo për gjithëpërfshirje, drejtorëve u është bërë pyetja: *A kërkojnë mësime të përfshihen në trajnime për mësime të gjithëpërfshirëse? Në këtë pyetje, përgjigjet e drejtorëve janë:*
- nuk ka plane konkrete;
 - po, janë të interesuar për çdo trajnim, sepse u duhet për licencim;

- po, janë të gatshëm për çdo trajnim;
- po (katër drejtorë kanë dhënë këtë përgjigje);
- po, pjesërisht;
- jo, (tre drejtorë);
- kërkojnë për shkak të licencimit, jo për zhvillim;
- po, kam 7,8 raste që kanë kërkuar.

Sipas disa drejtorëve, mësimdhënësit edhe nëse kërkojnë programe trajnimi, këtë e bëjnë për shkak të nevojës për licencim dhe jo se duan zhvillim profesional.

- Në pyetjen se a kërkojnë *programe specifike* trajnimi për nxënës me aftësi të kufizuara, përgjigjet e tyre ishin: vetëm 1 nga 13 drejtorët është deklaruar se mësimdhënësit kërkojnë, duan ta dinë. Të gjithë të tjerët janë përgjigj me *jo*.
- Ndërsa në pyetjen se a ekziston *fryma gjithëpërfshirëse* në shkollën tuaj, përgjigjet janë këto:
 - jo, nuk ka plane;
 - po;
 - po, (6 drejtorë përgjigjen të pasigurt);
 - po, ekziston fryma gjithëpërfshirëse;
 - deri-diku;

- po, në parim, por kur vjen puna për të punuar vetë, hezitojnë;
- jo, sa duhet;
- po, punojnë edhe si ekip edhe si grup.

Nëse analizojmë të gjitha këto përgjigje të drejtorëve, vetëm 3 prej tyre kanë dhënë përgjigje pozitive të sigurt se në shkollë ekziston fryma gjithëpërfshirëse. Sipas këtyre të dhënave, mund të konkludojmë se në shkollat „jogjithëpërfshirëse” edhe pse mësimdhënësit i pranojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, ende nuk është zhvilluar kultura gjithëpërfshirëse në këto shkolla.

4.3. Rezultatet e hulumtimit me mësimdhënësit mbështetës

Intervistës i janë përgjigjur 13 mësimdhënës mbështetës të shkollave „gjithëpërfshirëse”- si persona kyç që janë të lidhur drejtpërdrejt me procesin mësimor brenda shkollës dhe kanë informata të rëndësishme për procesin e gjithëpërfshirjes në shkollat përkatëse. Pyetjet e intervistës ishin përafërsisht të njëjta me pyetjet e intervistës me drejtorë shkollash. Të dhënat janë paraqitur në formën e njëjtë, sikurse edhe të dhënat e drejtorëve.

- Respondentët e intervistuar kishin *përvojë pune* në këtë pozitë prej 1,5 deri në 5 vite.
- Në pyetjen se a është shkolla juaj *e gatshme* për gjithëpërfshirje, respondentët përgjigjen:
 - po, (7 respondentë japin këtë përgjigje);

- po, shumica kanë ndjekur programe të zhvillimit profesional;
- mesatarisht, infrastruktura mesatare;
- po, është formuar fryma gjithëpërfshirëse, por nuk ka mjete didaktike;
- deri-diku, stafi ka pasur shumë trajnime, infrastruktura mungon, mjetet didaktike, tualeti, oborri, karriget janë të papërshtatshme, metodat e punës;
- infrastruktura, vetëm staza, trajnime deri-diku, kanë njohuri, por nuk po i mirëpresin, kam dëgjuar që ka raste të fëmijëve me aftësi të kufizuara, por nuk vijnë në shkollë;
- po, besoj;
- po, për nga infrastruktura jo.

Sipas mësimdhënësve mbështetës, në shkollat „gjithëpërfshirëse, ekziston frymë gjithëpërfshirëse, por shumë nga ata potencojnë mungesën e infrastrukturës së nevojshme brenda shkollave.

- Numri i nxënësve *me aftësi të kufizuara të përfshirë*, sipas respondentëve është nga 5 – numri më i vogël i nxënësve të përfshirë, e deri në 39 nxënës. Ky numër ndryshon varësisht nga shkolla.
- Ndërsa, vetëm 3 nga këto shkolla kanë nga 2-3 nxënës *të komuniteteve*. Në lokacionet që mbulojnë shkollat e tjera, nuk jetojnë komunitetet.

- Se çfarë *përgatitjesh* kanë bërë shkollat për gjithëpërfshirje, janë marrë këto përgjigje:
 - Trajnime për PIA- secili mësimitdhënës e plotëson, për gjithëpërfshirje, mbështetje për hartimin e PIA, riprodhim të materialit mësimor, modifikime të ndryshme, varësisht nga kërkesat e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve, asistoj në klasë, mësim individual;
 - infrastruktura e shkollës, banjë të veçanta, mësimitdhënës të trajnuar, trajnime brenda shkollës, numri i madh i nxënësve për vetëm një mësuese gjithëpërfshirëse;
 - trajnime me mësimitdhënës po, por në infrastrukturë nuk ka përgatitje, nuk ka pjerrina, tualete jo, nivel i ulët i infrastrukturës;
 - banjo, pjerrina po në katin e parë, të tjerat jo s'ka qasje, s'ka buxhet, me staf janë realizuar trajnime për PIA, gjithëpërfshirje, nuk janë përfshirë të gjithë;
 - trajnimi i mësimitdhënësve, përzgjedhja e mësueseve më të reja, të përfshihen në trajnime, të informohen, trajnime sipas specifikave, të udhëzohen se ku mund të gjejnë informacione, materiale të përshtatshme;

- infrastruktura, vetëm staza, kanë njohuri, por nuk i mirëpresin, programe trajnimi, vetëdijesimi deri-diku;
- infrastruktura jo, ka disa të trajnuar me programe për gjithëpërfshirje;
- jo shumë, jo për PIA nuk janë të trajnuar;
- staza për karroca, dy mësuese gjithëpërfshirëse, drejtorja i pranon, nuk i diskriminon, mësueset po ashtu;
- Janë mbajtur trajnime të shumta nga Save the Children dhe MASHT;
- 70% janë të trajnuar për PIA, etj.

Sipas respondentëve, në këto shkolla „gjithëpërfshirëse” (në të cilat punojnë respondentët) janë realizuar programe trajnimi për zhvillimin profesional të mësimeve. Mësuesit mbështeten nga ta, por rreth 40% e tyre deklarohen se pak apo hiq nuk është investuar në infrastrukturën e shkollës.

- Në pyetjen se a përfshihen të gjithë fëmijët e zonës që mbulon shkolla, pa dallim, janë dhënë këto përgjigje:
 - Po, ka kërkesa edhe nga jashtë;
 - Po, edhe nga lagjet e tjera;
 - Po, por ka raste të pafundshme, shkolla i pranon, por prindërit i fshehin, nuk marrin të dhëna nga ofiqaria;
 - po, pa dallim;

- po, edhe jashtë zonës;
- po, ata që lajmërohen, por ka edhe që nuk vijnë në shkollë;
- jo, tashti është formuar ekipi për vlerësim;
- po, (5 respondentë kanë dhënë këtë përgjigje);
- po, përveç komunitetit që i ndalin nga klasa e 5,6;
- po, vijnë edhe nga rrethina dhe fshatrat.

Sipas të dhënave, shkollat „gjithëpërfshirëse” për shkak të specifikave të mbështetjes, përfshijnë fëmijë edhe nga jashtë zonës të cilat ato mbulojnë, por ka edhe fëmijë të identifikuar me aftësi të kufizuara që nuk vijnë në mësimin.

- A janë të *trajnuar* mësimdhënësit e shkollës për gjithëpërfshirje? Përgjigjet e respondentëve janë:
 - jo të gjithë, por shumica;
 - shumica po,7,8 kanë kryer ZHP, edukimin inkluziv, pa shpëputje nga puna;
 - jo pjesërisht, për PIA po, grupi i moshës së vjetër hezitojnë t’i trajnojnë dhe t’i pranojnë nxënësit;
 - jo të gjithë;
 - për PIA po i trajnoj, por kërkojnë trajnime dhe kanë nevojë;
 - më të vjetrit jo, por po, shumica;

- po;
- pjesërisht (4 respondentë);
- të gjithë e kanë ndjekur PIA, ndërsa mësuesit dhe kujdestarët e klasave edhe tri module;
- të gjithë për PIA;
- po, 70%;

Sipas mësimdhënësve mbështetës, shumica e mësimdhënësve në shkollat e tyre janë përfshirë në programe specifike trajnimi për gjithëpërfshirje. Por, cekin mosinteresimin për zhvillim të mësimdhënësve të moshës më të vjetër.

- Në pyetjen: A i dini se *çfarë nevoja* për trajnime kanë mësimdhënësit e shkollës suaj ? Përgjigjet e tyre janë:
 - kërkojnë diçka praktike;
 - kanë nevojë për PIA, asnjëri nuk mund të bëjë në mënyrë të pavarur;
 - janë të paktë 3,4,tjerët janë trajnuar;
 - po për zhvillim, për gjithëpërfshirje, vetëdijesim, konceptin e gjithëpërfshirjes nuk e kuptojnë;
 - po, për PIA jam unë, por kanë nevojë;
 - gjuha e shenjave, Brajli, ADHD, punë praktike me këto raste në klasë;
 - po prej trajnimit bazik;

- për specifikat e këtyre fëmijëve, për metodologji të punës;
- për PIA, kategorizim, metodologji të mësimdhënies, për specifikat e aftësisë së kufizuar, nuk janë shumë të dëshiruar, por nuk po i pyesim shumë;
- kanë nevojë për trajnime, por vetëm 2,3 e kanë marrë me qetësi, të tjerët kanë nevojë për trajnime, për planprograme më të qarta;
- në praktikë është më problematike, trajnime kanë, nga kl. 6-9 nuk merren shumë me ta;
- po, ka kërkesa.

Sipas mësimdhënësve mbështetës, mësimdhënësit kanë nevojë për programe specifike të trajnimit sipas llojit të aftësisë së kufizuar.

- Në pyetjen se *a hezitojnë* mësimdhënësit të pranojnë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasë, respondentët janë përgjigjur:
 - të rinjtë po, të vjetrit jo. Kanë përvojë dhe i socializojnë;
 - jo;
 - hezitojnë t'i pranojnë, edhe gjeneratat e reja hezitojnë dhe kanë vërejtje se i pengojnë në punë, merre t'i puno në zyre me ta, ka pasur konflikt, nuk i përfillë instancat e shkollës;

- zakonisht jo, por numri i madh në klasa e drejtori nuk pranon ta zvogëlojë numrin në atë klasë, problemi është te menaxhimi;
- po, ka pasur mësuese vullnetare, por ka pasur që, ka pasur frikë të punojë me ta, s'ka qenë e gatshme, por ka pasur që kanë thënë s'dua të punojë me ta, ma ka bërë me inat, por ka raste që hezitojnë;
- po, kërkojnë ndihmës;
- jo, kanë qasje pozitive;
- jo me dëshirë, jo te unë, por dërgoje te tjetri, zvarritet vendimi;
- po, sidomos në klasë të parë thonë dërgoje në klasë të bashkangjitur, për komunitete nuk hezitojnë;
- disa jo, disa po;
- ka disa raste kur ka numër të madh të nxënësve.

Edhe pse kanë mbështetje brenda shkollës, sipas mësimeve mbështetës, ende një numër i mësimeve hezitojnë të pranojnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Këto hezitime, 2 respondentë i potencojnë tek moshat e reja të mësimeve.

- A hasni në pakënaqësi gjatë *regjistrimit* të nxënësve në klasë të parë?
 - pak po, ankesa ka, por jo kundërshtime;
 - jo, unë i di, i njoh dhe i shpërndaj njësoj;

- jo shumë të theksuara, por ka pasur raste, është dashur të bazohemi në udhëzim administrativ;
- jo, unë e psikologja i referojmë, i përzgjedhim ato që kanë trajnime dhe shprehin dëshirë dhe vullnet me i marrë;
- kur themi veç u krye, nuk refuzojnë;
- po, (3 respondentë);
- s'kam hasur;
- qoni në klasë të bashkangjitur;
- jo, (2 respondentë);

Sipas respondentëve, mësimdhënësit pjesërisht hezitojnë për t'i pranuar nxënësit me aftësi të kufizuara në klasë, ndërsa, ka edhe të atillë që lajmërohen vullnetarë.

- *Vështirësitë* të cilat i potencojnë mësimdhënësit, sipas respondentëve janë:
 - Brengosen me rezultatet, zhgënjehen, pengon në orë, sfida të tjera;
 - nuk ka mjete didaktike, nuk ka sallë të edukatës fizike;
 - numri i madh i nxënësve, nuk po di si të punoj me ta, është edhe gjykim dhe stereotip se ky është për shkollë speciale;
 - më shumë angazhim dhe kohë, çështja e trajnimeve, mungesë të materialeve, teknikat e punës, mungon puna e konkretizuar;

- materialet e punës, kushtet e klasës, metodat e punës, numri i madh i nxënësve, PIA;
- numri i madh i nxënësve, PIA, metodat e punës;
- PIA, metodologjitë e punës, përshtatja e materialit;
- nxënësit me NVA i shohin si pengesë;
- nuk mundem tani edhe me fëmijë të tjerë, kërkojnë ndihmës;
- në praktikë është problem;
- numri i madh i nxënësve, komoditeti i klasës, mungesa e mjeteve didaktike.

Sipas mësimdhënësve mbështetës, mësimdhënësit ankohen për kushtet e pavolitshme të punës për gjithëpërfshirje dhe mungesën e njohurive të nevojshme, por janë të ndikuar edhe nga paragjykimet.

- A kërkojnë mësimdhënësit *mbështetje*, përgjigjet e respondentëve janë:
 - po, (4 respondentë);
 - po, për modifikim të materialeve, të testeve, për hartimin e PIA;
 - po, një numër kërkojnë modifikim, mënyrën e qasjes, metodologji të punës, cikli i lartë - këshilla, hartimin e PIA;

- po, zakonisht për hartimin e PIA, metodat e punës, sjelljet me ta, thjeshtësimin e punës, përshtatjen e materialeve;
- po, kemi shumë takime;
- ata që i kanë në klasa angazhohen, por jo me vullnet;
- po, gjithmonë;
- po, në vlerësim, metodologji, përshtatje;
- po, kërkojnë ndihmë, por nuk duan t'i marrin këshillat tona;
- po, gjithmonë;
- po, për PIA, këshilla, metoda të punës.

Mësimdhënësit mbështetës deklarohen se, mësimdhënësit përfshirës kërkojnë mbështetje profesionale dhe teknike nga ta.

- A kërkojnë mësimdhënësit *trajtime* për mësimdhënie gjithëpërfshirëse?
 - Po, (5 respondentë);
 - nëse kanë nevojë, po;
 - gjeneratat e reja, po;
 - po, kërkojnë vazhdimisht, por edhe shkollat e tjera, por s'ka mbështetje;
 - po, thonë kam nevojë për këtë;
 - jo;

- po, dëshirojnë shumë të përfshihen në trajnime;
 - jo, s'kanë shpreh dëshirë;
 - disa po, disa edhe pritojnë;
 - te unë jo;
- A kërkojnë mësimdhënësit *programe specifike* të trajnimit?
- po, (4 respondentë);
 - jo, vetëm nëse ka diçka të paqartë;
 - gatishmëri kanë dhe kemi nevojë, pranojnë dhe kërkojnë, mundohen por nuk po dinë të punojnë;
 - jo, nuk kërkojnë trajnime, por vetëm ndihmë nga unë;
 - po, kërkojnë;
 - nëse kanë nevojë, po;
 - nuk dinë ndoshta të kërkojnë;
 - jo, (4 respondentë);

Sipas respondentëve, mësimdhënësit pjesërisht kërkojnë të përfshihen në programe trajnimi specifike për gjithëpërfshirje.

- A mendoni se në shkollën tuaj ekziston *fryma gjithëpërfshirëse*?

- Po fillimet ishin të vështira por tashti është shumë normale, ka ndikuar lënda e inkluzionit në programin pa shkëputje nga puna;
- po, ekziston fryma gjithëpërfshirëse në shkollë, ka nevojë ende për t'u bërë, vizita, ekskursionet;
- pas gjithë kësaj nuk ka bllokadë totale, shoh aspekte pozitive, por ka vështirësi, pika më e dobët është DKA, s'ka zyrtarë për gjithëpërfshirje, është themeluar ekipi për vlerësim, por nuk i dinë detyrat, nuk kanë informata, unë rekomandoj që të gjithë mësimit të përfshihen në program për zhvillim profesional finlandez, ngrit vetëdijesimin dhe lehtëson punën e tyre - 2 vite studim;
- po, tash nuk ka vështirësi, më herët po, vështirësitë janë nga lart, jo mësimit të përfshihen;
- po, jemi mësuar, e kemi kaluar këtë fazë, ka nevojë për trajnime specifike;
- deri-diku, është proces i vështirë, nuk kemi bashkëpunëtorë profesionalë, në komunë nuk kanë njohuri;
- në çdo klasë ka që mësimit të përfshihen punojnë me 10-15 nxënës, ndërsa 5-10 tjerët janë pasivë, mësuesit nuk merren me ta;

- klasorët i pranojnë më lehtë, ndërsa arsimtarët më me vështirësi i pranojnë;
- po, ka vështirësi më shumë te mësimdhënësit lëndor, sepse as që donë të mendojnë për PIA;
- kanë filluar t'i kuptojnë;
- po;
- mendoj që po;
- po, ka.

Sipas mësimdhënësve mbështetës të shkollave, niveli i *vetëdijesimit të mësimdhënësve* për gjithëpërfshirje është ngritur. Në disa shkolla frymon gjithëpërfshirja, e në disa pjesërisht. Ekzistojnë dallime në qëndrimet e mësimdhënësve edhe brenda shkollave të njëjta, por dallimet ekzistojnë edhe ndërmjet shkollave.

5. ANALIZA E REZULTATEVE DHE KRAHASIMI I TYRE

Hulumtimet e bëra në vende të ndryshme të botës kanë identifikuar disa karakteristika personale, të cilat ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve. Po ashtu, edhe në Kosovë qarkullojnë opinione se: moshë, gjinia, përgatitja shkollore, zhvillimi profesional, përvoja e punës, përvoja në gjithëpërfshirje, niveli në të cilin punojnë, vendi (kultura), janë karakteristikat personale të mësimdhënësve apo faktorë të cilët ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së

gjithëpërfshirjes. Këta faktorë janë grupuar në: faktorë të brendshëm dhe faktorë të jashtëm.

Andaj, ndër objektivat e këtij hulumtimi ishte edhe krahasimi i këtyre faktorëve – variabla të pavarura dhe ndikimi i tyre në variablat e varura të cilat përcaktojnë qëndrimet e mësimit në Kosovë. Sipas kësaj objekte, janë hartuar edhe pyetje në pyetësor.

Analiza e rezultateve dhe krahasimi është bërë duke krahasuar përgjigjet e mësimit të grupuar sipas karakteristikave personale - si faktorë me ndikim, me përgjigjet në pyetjet kryesore që shprehin qëndrimet e mësimit, si:

- Nëse fëmijët me aftësi të kufizuara duhet arsimuar në klasa të rregullta apo klasa të veçanta;
- Nëse fëmijët me nevojë të veçanta arsimore në klasë, i pranoni me dëshirë, nga përgjegjësia, nga keqardhja apo nuk do t'i pranoja fare;
- Nëse do të dëshironit të jeni mësues gjithëpërfshirës apo jo.

Janë bërë edhe krahasime dhe analiza të përgjigjeve në pyetjet e tjera, varësisht nga specifikat e grupeve të faktorëve dhe konteksti i variabla.

5.1. Ndikimi i disa faktorëve personal në qëndrimet e mësimit për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes

Është supozuar se disa karakteristika personale mund të janë faktorë me ndikim në qëndrimet e mësimit, prandaj, për

të bërë një vlerësim të ndikimit të tyre janë nxjerrë rezultatet në vazhdim.

5.1.1. Ndikimi i gjinisë në qëndrimet e mësimdhënësve.

Nga respondentët e përfshirë në hulumtim, 72.73% janë të gjinisë femërore dhe 27.27% të gjinisë mashkullore.

Nga këto shifra, 52.5% e femrave dhe 34.6% e meshkujve mendojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të arsimohen në klasa të rregullta, të tjerët mendojnë në klasa të veçanta. Po ashtu, 12.5% e meshkujve janë deklaruar se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk do t'i pranoja fare në klasë, ndërsa këtë përgjigje e kanë dhënë vetëm 2.75% e femrave. Ndërsa 46.7% e meshkujve deklarohen se nuk do të bënin dallime ndër grupe të marginalizuara - dhe afërsisht njëjtë deklarohen edhe femrat (46%).


Përveç dallimit në të menduar se femrat kanë mendime më pozitive për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasa të rregullta - krahasuar me meshkujt, gjatë hulumtimit, ndërmjet gjinive nuk janë gjetur dallime të tjera të theksuara.

5.1.2. Ndikimi i moshës në qëndrimet e mësimdhënësve.

Mosha si faktor psiko-fizik e mësimdhënësve është supozuar se ndikon në qëndrimet e tyre, duke pasur parasysh faktin se gjithëpërfshirja është një filozofi e re. Shumë mësimdhënës më të moshuar kanë kaluar nëpër sisteme të ndryshme arsimore, ku fëmijët me aftësi të kufizuara janë arsimuar në klasa apo shkolla të veçanta, prandaj është supozuar se ky grup i mësimdhënësve e kanë më të vështirë përshatjen me reformat dhe sistemin e ri arsimor.

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se: nga mësimdhënësit mbi moshën 51 -65 vjeç, vetëm rreth 36% e tyre mendojnë se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet arsimuar *në klasa të rregullta*, ndërsa kjo përqindje është më e lartë tek mësimdhënësit mbi moshën 21-50 vjeç (mbi 50%). Të tjerët mendojnë se nxënësit me nevoja të veçanta duhet arsimuar në *klasa- shkolla speciale*.

Ndërsa, sa i përket njohurive për llojet e aftësive të kufizuara, nuk janë gjetur dallime të dukshme, krahasuar grupmoshat. Po ashtu, dallime nuk janë gjetur as sa i përket preferencave për përfshirje të grupeve të marginalizuara dhe llojeve të dëmtimit, gjë e cila vërehet edhe nga grafiku në vijim. Të gjitha grupmoshat preferojnë përafërsisht njëjtë, fëmijët me dëmtime fizike:



Grafiku 20. Preferencat e grupmohave të mësimeve sipas llojit të dëmtimit


Ndërsa, mbi 53-76% të grupmohave deri në 60 vjet ndjehen të sigurt për përfshirje të të gjithë fëmijëve pa dallim, dhe po ashtu përgjigjen vetëm 44.4% të grupmoshës mbi 60 vjet. *Më të sigurt* ndihen grupmoshat më të reja, pastaj kjo përqindje bie sipas moshës.

Vlerë në klasë, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore i konsiderojnë vetëm 39% e grupmoshës mbi 60 vjeç – të tjerët i konsiderojnë pengesë, ndërsa përgjigje më pozitive japin mësimeve nga grupmosha 21-30 vjeç, të cilët, vlerë në klasë i konsiderojnë mbi 63%, shifrat bien sipas grupmohave.

Tabela 2: Sa i konsiderojnë mësimdhënësit „vlerë “NNVA

grupmoshat	vlerë
21-30	63.1
31-40	55.7
41-50	55.7
51-60	50.0
mbi 60	39.7

Po ashtu, pak nga mësimdhënësit ndihen *shumë mirë* (më shumë nga grupmoshat 21- 59 vjeç) apo *mirë* me nxënës me nevoja të veçanta arsimore në klasë. Ndërsa, se *ndihen keq* me nxënës të përfshirë janë deklaruar gati 1/3 e mësimdhënësve me moshën mbi 60 vjeç.(shih grafikun)



Grafiku 21. Si ndihen mësimdhënësit në klasa gjithëpërfshirëse, sipas grupmoshës

Nga të gjeturat mund të konkludojmë se mosha ndikon në dallimin e mendimeve të mësimitdhënësve për procesin e gjithëpërfshirjes. Këtë e potencojnë edhe drejtorët e shkollave.


5.1.3. Përvoja e punës në arsim - është faktor i rëndësishëm i cili ndikon në krijimin e qëndrimeve të mësimitdhënësve për gjithëpërfshirje. Sipas të dhënave (shih grafikun 4), të gjithë mësimitdhënësit kanë përvojë në arsim, aq sa mund të kenë formuar edhe qëndrimet e tyre për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, pavarësisht se kanë apo jo përvojë në gjithëpërfshirje.

- Sipas të gjeturave, mësimitdhënësit *me përvojë pune* nga 1-30 vjet, rreth 50% prej tyre thonë se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet arsimuar në klasa të rregullta, ndërsa ata me përvojë mbi 30 vjet, vetëm 32.4% përgjigjen njëjtë. Të gjithë të tjerët kanë dhënë përgjigje se FNVA duhet arsimuar në klasa apo shkolla të veçanta (speciale).
- Ndërsa se a mund të përfshihen fëmijët me aftësi të kufizuar në klasat e tyre, sipas përvojës përgjigjet janë: mësimitdhënësit me mbi 30 vjet përvojë, më pak kanë dhënë përgjigje pozitive (rreth 44%), krahasuar me mësimitdhënësit me përvojë më të vogël.

Tabela 3: Përgjigjet pohuese sipas përvojës në punë

Përvoja/vite	Po %
1-5	70.1
6-10	67
11-15	71.25
16-20	62.7
21-25	60.3
26-30	69.5
mbi 30	44.8

Po ashtu, dallimet bazuar në përvojën e punës janë të theksuara edhe tek përgjigjet se *a do të dëshironin* të jenë mësimdhënës gjithëpërfshirës. Sipas të gjeturave, 81.4% e mësimdhënësve me përvojë pune nga 1-5 dëshirojnë të jenë mësimdhënës gjithëpërfshirës, ndërsa kjo shifër bie në 59% tek mësimdhënësit me përvojë mbi 30 vjeçare.




Grafiku 22. A dëshironi të jeni mësimdhënës gjithëpërfshirës

- Sipas të gjeturave, mbi 40% të mësimitdhënësve me *më shumë përvojë* pune nuk dëshirojnë të ballafaqohen me sfidat e gjithëpërfshirjes, ndërsa mësimitdhënësit me më pak përvojë pune preferojnë më shumë gjithëpërfshirjen.

5.1.4. Përvoja e punës në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta brenda klasës është tregues i sigurt që reflekton bindjet e mësimitdhënësve për krijimin e qëndrimeve. Rreth 65% e respondentëve janë deklaruar se kanë këtë përvojë, ndërsa pjesa tjetër janë deklaruar se nuk kanë pasur asnjëherë brenda klasës fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.


- Mësimitdhënësit *me përvojë pune në gjithëpërfshirje*, prej 1-5 vjet, mbi 50% deklarohen se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet arsimuar në shkollë të rregullta, ndërsa ata me përvojë nga 6-9 vjet mbi 57% deklarohen po ashtu, në klasë të rregullta, ndërsa ata me mbi 10 vjet, vetëm 45% e tyre japin këtë përgjigje. Po ashtu, edhe ata pa përvojë në gjithëpërfshirje, mbi 41% deklarohen se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet arsimuar në klasë të rregullta (klasë normale apo të zakonshme).
- Mësimitdhënësit me përvojë në gjithëpërfshirje deklarohen se a *bëjnë dallime* apo jo, për përfshirje në bazë të grupeve të marginalizuara. Sipas të gjeturave, shumica nga ta, rreth mbi 70% deklarohen se nuk

bëjnë dallime ndër grupe të marginalizuara për gjithëpërfshirje. Grafiku në vijim pasqyron se cilat të dhënat se, fëmijët nga cilat grupe të marginalizuara, preferojnë më tepër t'i përfshijnë në klasat e tyre.




Grafiku 23. Preferencat për përfshirje të grupeve të marginalizuara

Por, mësimdhënësit me përvojë në gjithëpërfshirje, bëjnë dallime sipas llojit të aftësive të kufizuara. Të gjithë mësimdhënësit, pavarësisht përvojës, deklarohen se më lehtë do të punonin me nxënës me dëmtime fizike, ndërsa më së paku me dëmtime në të dëgjuar.



Grafiku 24. Preferencat sipas llojit të aftësisë së kufizuar

Meqë, mësimdhënësit me përvojë gjithëpërfshirëse pretendohet të jenë zhvillues të procesit, u është bërë pyetja se *si ndihen nëse në klasë kanë fëmijë me nevoja të veçanta*, grafiku në vijim:



Grafiku 25. Si ndihen mësimdhënësit sipas grupeve të përvojës

Sipas grafikut, nga të gjitha grupet, pjesa më e madhe e mësimit ndihet mirë me fëmijë me nevoja të veçanta në klasë, por edhe një shifër e konsiderueshme janë deklaruar shumë mirë, përafërsisht edhe një numër i ngjashëm, janë deklaruar, jo mirë.

5.1.5. Trajnimet në programet për gjithëpërfshirje.

Programet për zhvillim profesional për gjithëpërfshirje kanë ndikim shumë të rëndësishëm në përgatitjen profesionale dhe vetëdijesimin e mësimit ndihet mirë. Sipas të dhënave, disa nga mësimit ndihet mirë kanë marrë pjesë në disa programe specifike për gjithëpërfshirje. (shih tabelën nr.4)


Tabela 4: Pjesëmarrja e mësimit ndihet mirë në programet e trajnimit për gjithëpërfshirje

Trajnime në programet për gjithëpërfshirje	%
Programin për zhvillim profesional nga FSDEK	18.16
Teknikat e mësimit ndihet mirë aktive për gjithëpërfshirje (EducAid-TEMA)	23.88
Nga qendrat burimore	6.73
Plani individual i arsimit	27.76
Mësimit ndihet mirë me nxënësin në qendër (MNQ)	59.18
Tjetër	19.18

Programe të tjera të trajnimit, respondentët deklarojnë programe nga Save the Children, MKLSH, KKK, Hap pas hapi, programe psiko-sociale, kursin e shkrim-leximit, vlerësimi formativ, vështirësitë në të nxënë, kursi i matematikës, etj.

Nga tabela vërehet se pjesërisht, apo vetëm disa nga mësimdhënësit kanë qenë të përfshirë në disa nga programet e trajnimit për punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, por kjo pjesëmarrje në ndonjë program nuk është e mjaftueshme, gjë të cilën e kanë potencuar edhe vetë mësimdhënësit për nevojat e tyre për përfshirje në programe trajnimi më të kompletuar për gjithëpërfshirje.

Për të parë *ndikimin* e programeve të trajnimit në qëndrimet e mësimdhënësve është bërë krahasimi se, sa nga mësimdhënësit e përfshirë në këto programe trajnimi deklarohen se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet të përfshihen në klasa të rregullta dhe sa mendojnë në klasa të veçanta. Për rezultatet e përgjigjeve shih grafikun 26:



Grafiku 26. Ndikimi i programeve të trajnimit në qëndrimet e mësimdhënësve

Sipas grafikut, edhe pse mësimdhënësit janë trajnuar në disa nga programet për gjithëpërfshirje, në përqindje më të lartë

favorizojnë klasat e veçanta, me përjashtim të të trajnuarve për PIA.

Nga të gjitha programet e tjera të trajnimit, qëndrimet e pjesëmarrësve të tyre janë të ndara: më shumë preferojnë klasat e veçanta se sa ato të rregullta.


5.1.6. Gjendja aktuale - Nëse në klasë ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, është faktor që ndikon në reflektimin e qëndrimeve të mësimitdhënësve. Në këtë pyetje, përgjigjet e mësimitdhënësve tregojnë se 40% e tyre aktualisht kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasë ndërsa, 60% nuk kanë. Nga mësimitdhënësit të cilët aktualisht kanë nxënës me nevoja të veçanta në klasë, 52.4% e tyre deklarohen se duhet arsimuar në klasa të rregullta, ndërsa të tjerët preferojnë që FNVA duhet arsimuar në klasa të veçanta. Ndërsa, ata të cilët aktualisht nuk kanë nxënës me nevoja të veçanta arsimore deklarohen: 45.7% në klasa të rregullta, 44.8% në klasa të veçanta, ndërsa 9,5% nuk janë deklaruar.

Të gjeturat e përgjithshme tregojnë se 51.93% nga mostra e përgjithshme e përfshirë në hulumtim, mendojnë se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet të arsimohen në klasa të rregullta, kurse 47.89% deklarohen për klasa - shkolla të veçanta.

Bazuar në të gjeturat nga mostra e përfshirë në hulumtim: vetëm 51% janë deklaruar se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore duhet përfshirë në klasa të rregullta; afër 50% se me dëshirë i pranojnë fëmijët në klasë; 20% se ndjehen shumë mirë me nxënës të përfshirë, si dhe shumë të gjeturave të tjera dhe arsyeve që ata kanë potencuar, në qëndrimet e mësimitdhënësve. Rol të rëndësishëm luajnë edhe faktorë të tjerë, si: mbështetja nga

shkolla dhe institucionet relevante, vendi, niveli në të cilin punon mësimitdhënësi, etj.

- Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 591 mësimitdhënësi, nga niveli klasor dhe lëndor. Nga ta, 55.75% janë nga niveli 1 - mësimitdhënësi klasor dhe 43.87 % nga niveli 2 - mësimitdhënësi lëndor.
- Sipas të gjeturave, 30,9% e mësimitdhënëseve klasor dhe 41,3% e mësimitdhënëseve lëndorë kanë nxënësi të përfshirë në klasat e tyre.



Grafiku 27. Nivelet në të cilat punojnë mësimitdhënësit në shkollë

Nga numri i të deklaruarve të nivelit klasor 49% prej tyre thonë se me dëshirë i pranojnë nxënësit me nevoja të veçanta në klasë dhe të njëjtën përgjigje japin edhe mbi 48,1% përgjigjen edhe mësimitdhënësit nga niveli lëndor.

Ndërsa në pyetjen *se ku duhet arsimuar nxënësit me nevoja të veçanta arsimore*, ka dallim në mendime: mbi 53% nga mësimdhënësit klasor dhe 40,8% nga mësimdhënësit lëndor përgjigjen në klasa të rregullta. Pjesa tjetër, nga të dy nivelet mendojnë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet arsimuar në klasa apo shkolla të veçanta. 62.4% e mësimdhënësve klasor deklarohen se janë në dijeni për llojet e aftësisë së kufizuar dhe po ashtu, 69% e mësimdhënësve lëndor deklarohen pozitivisht. Ndërsa sa i përket dallimeve për përfshirje bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar, nuk ka shumë dallim në përgjigje pasi që 75.7% e mësimdhënësve klasor dhe 70.8% e mësimdhënësve lëndor përgjigjen se nuk do të bënin dallime për përfshirjen e nxënësve. Ndërsa 66.5% e mësimdhënësve klasor dhe 57.4% e mësimdhënësve lëndor mendojnë se mund të përfshijnë nxënës pa dallim aftësie në klasat e tyre.


Po ashtu, 52.8% e mësimdhënësve klasor dhe 54.6% e mësimdhënësve lëndor, FNVA i konsiderojnë *vlerë* në klasë përderisa të tjerët i konsiderojnë *pengesë*.

Ndërsa, në pyetjen se si do të ndiheshin nëse në klasat e tyre do të kishin fëmijë me aftësi të kufizuara, përqindjet e përgjigjeve ishin shumë të përafërta. Diferenca ndërmjet mësimdhënësve klasor dhe lëndor është tek mendimet e tyre se ku duhet arsimuar fëmijët me NVA (rreth 12%), ndërsa në përgjigjet e pyetjeve të tjera, nuk vërehen dallime të theksuara të mësimdhënësve klasor dhe të atyre lëndor.

Se ekzistojnë dallime të theksuara në qëndrime të mësimdhënësve në Kosovë kanë qarkulluar opinione, dhe po ashtu janë deklaruar edhe disa drejtorë shkollash dhe mësimdhënës mbështetës.

Sipas të dhënave në grafikun vijues, mësimdhënësit në përqindje përfaqësojnë të njëjtë janë përfshirë në programe trajnimi për gjithëpërfshirje. Shifrat dalluese më të theksuara vërehen vetëm në përfshirjen e programit të PIA. Nga këto të gjetura, mund të konstatojmë se, përfshirja përfaqësojnë të njëjtë në programe të trajnimit ka ndikuar në mosdallim të theksuar edhe në përgjigjet e tyre.


Por, mbi 30% të mësimdhënësve nuk kanë qenë të përfshirë në asnjërin nga këto programe trajnimi.



Grafiku 28. Pjesëmarrja në trajnime sipas nivelit

5.1.7. Vendi - në të cilin gjendet shkolla, po ashtu është identifikuar faktor i cili ndikon në qëndrime të mësimdhënësve. Nga mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim, prej tyre 80.1% janë nga shkollat urbane, ndërsa 19.9% janë nga shkollat rurale. Ky dallim në shifra është për faktin se në mostrën e hulumtimit janë përfshirë 13 shkolla „gjithëpërfshirëse” të cilat janë të gjitha në vendet urbane, ndërsa 14 shkollat e tjera të përfshira në hulumtim janë përzgjedhur në bazë të kriterit të përzgjedhjes së mostrës, në mënyrë të barabartë, nga vendet urbane dhe rurale.

Mirëpo, sipas të dhënave, mësimdhënësit në shkollat urbane kanë qëndrime më pozitive për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta, krahasuar me mësimdhënësit në shkollat rurale. (Shih grafikun në vijim)




Grafiku 29. Mendimet e mësimdhënësve nga vendet urbane dhe rurale për përfshirjen e FNVA

Nga të dhënat në grafik, mund të konstatojmë se për qëndrimet e mësimdhënësve ndikim mund të ketë edhe vendi ku gjendet

shkolla, për shkak të specifikave dalluese, si: kultura, mentaliteti i rrethit, kushtet, etj., të cilat i dallojnë vendet urbane nga ato rurale në Kosovë.

5.1.8. Mbështetja e mësimdhënësve - Edhe mbështetja e mësimdhënësve po ashtu, është konsideruar si një tregues që mund të ndikojë në qëndrimet e mësimdhënësve. Në mostrën e hulumtimit janë përfshirë shkolla „gjithëpërfshirëse” të cilat mbështeten nga mësimdhënësit mbështetës – si staf i shkollës dhe u është kushtuar rëndësi e veçantë mbështetëse edhe nga MASHT, po ashtu, edhe shkolla „jogjithëpërfshirëse”, por të cilat kanë nxënës të përfshirë, të cilat mbështeten nga mësimdhënësit udhëtues. Dallimet në qëndrimet e këtyre dy grupeve, do të krahasohen në bazë të të dhënave në grafik:




Grafiku 30. Qëndrimet e mësimdhënësve sipas grupeve të shkollave

Sipas të dhënave, qëndrimet e mësimdhënësve të shkollave „gjithëpërfshirëse” dallojnë nga qëndrimet e mësimdhënësve të

shkollave „jogjithëpërfshirëse”. Mbi 53.5% e mësimitdhënësve të shkollave „gjithëpërfshirëse” mendojnë se nxënësit me NVA duhet të arsimohen në klasa të rregullta, ndërsa njëjtë mendojnë 41.5% nga shkollat „jogjithëpërfshirëse”.

Se, mbështetja institucionale është faktor me ndikim në qëndrimet e mësimitdhënësve, tregojnë të dhënat e dala nga hulumtimi të paraqitura në grafikun në vijim:



Grafiku 31. Nga kush mbështetjen mësimitdhënësit

Shifra - mbi 55% e mësimitdhënësve të shkollave „gjithëpërfshirëse” të cilët mbështeten nga mësimitdhënësit mbështetës është përafërsisht në përputhje me shifrën e mësimitdhënësve të deklaruar po nga këto shkolla, (shih grafikun nr. 31) se NVVA duhet arsimuar në klasa të rregullta. Ndërsa, në shkollat „jogjithëpërfshirëse” mbështetja konsiderohet se duhet ofruar nga mësimitdhënësi udhëtues, pedagogu apo psikologu - nëse ka shkolla. Edhe nga shkollat „jogjithëpërfshirëse” mësimitdhënësit e deklaruar për mbështetje nga mësimitdhënësi udhëtues, pedagogu apo psikologu i shkollës paraqet numër të

përafërt me atë në grafikun nr. 30, (41.5 %) të cilët mendojnë se nxënësit me NVA duhet përfshirë në klasa të rregullta.

Nga të dhënat, mund të konstatojmë se mbështetja e mësimdhënësve për gjithëpërfshirje, ka ndikim të theksuar në qëndrimet e tyre.

Përveç mbështetjes profesionale, në qëndrimet e mësimdhënësve ndikojnë edhe faktorë të tjerë të jashtëm, si: numri i madh i nxënësve në klasa, orari i mësimi, mungesa e mjeteve mësimore, si dhe shumë faktorë të tjerë të cilët mësimdhënësit i kanë cekur (shih tabelën nr.1- arsyet e mësimdhënësve për përgjigjet e tyre).

Përveç këtyre faktorëve, në qëndrimet ndikojnë edhe *cilësitë e personalitetit* të mësimdhënësve, por që nuk kanë qenë objekt i këtij studimi.

5.2. Gjetjet e përgjithshme

Sipas gjetjeve të përgjithshme, rreth 76% e mësimdhënësve mendojnë se shkollat në të cilat ata punojnë janë *të gatshme* për gjithëpërfshirje, që nënkupton infrastrukturën e shkollës, përgatitjen e mësimdhënësve dhe menaxhimin e shkollës. Po ashtu, 71,94% deklarohen se ndihen *të sigurt në aftësitë* e tyre për të punuar me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe prej 68.2% deri 98.8% janë përqindjet e përgjigjeve për gatishmërinë e tyre për plotësimin e kriterëve për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasë. Ata, sipas të dhënave, deklarohen se janë të gatshëm për përshtatjen e planifikimit mësimor, të hartojnë PIA, të bashkëpunojnë me kolegë dhe ekspertë nga jashtë, të kërkojnë programe trajnimi, të jenë mësimdhënës

gjithëpërfshirës dhe të përfshijnë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasë (grafiku nr. 17).

Nga analiza e këtyre të dhënave mund të konkludojmë se, mësimitdhënësit mendojnë se shkollat janë të përgatitura për gjithëpërfshirje dhe se në aspektin profesional ata janë të gatshëm për gjithëpërfshirje, që do të thotë se kanë njohuri dhe mundësi për këtë proces.

Mirëpo, kjo shifër *bie* kur pyeten se ku duhet të arsimohen fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, dhe vetëm 51,93% thonë se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet të arsimohen në klasa të rregullta. Po ashtu, afër (49.91%) shprehen se „me dëshirë” i pranojnë fëmijët me nevoja të veçanta në klasë, 58.72% e mësimitdhënësve thonë se nxënësit me nevoja të veçanta arsimore i konsiderojnë si „vlerë” në klasë. 53.58% e mësimitdhënësve deklarohen se ndjehen „mirë” nëse kanë fëmijë me nevoja të veçanta në klasë. Po ashtu, nga përgjigjet e drejtorëve, rreth 46.1% e tyre deklarojnë se mësimitdhënësit nuk hezitojnë për t’i pranuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në klasë, por i potencojnë disa vështirësi që hasin mësimitdhënësit. Ndërsa, mësimitdhënësit mbështetës të shkollave „gjithëpërfshirëse”, rreth 30% e tyre deklarohen se mësimitdhënësit nuk hezitojnë për t’i pranuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në klasa, ndërsa pjesa tjetër (70%), janë përgjigjur „pjesërisht”, që do të thotë se në shkolla të njëjta një pjesë e mësimitdhënësve nuk hezitojnë, por ka edhe të atillë që deklarohen vullnetarë.

Rreth 22% e mësimitdhënësve të përfshirë në hulumtim, japin përgjigje bindëse se ndjehen „shumë mirë” me përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasë. Shkalla e

matjes „shumë mirë” është shkalla më e lartë krahasuese dhe shpreh bindshmëri të qëndrimeve të tyre pozitive. Përbërësit kognitiv dhe përbërësit afektivë të qëndrimeve të këtij grupi të mësimdhënësve janë të harmonizuar – kanë qëndrime pozitive dhe pritjet për zhvillim të gjithëpërfshirjes janë të besueshme.

Po ashtu, sipas të gjeturave mbi 38% e mësimdhënësve, fëmijët me nevoja të veçanta në klasë i pranojnë nga përgjegjësia morale dhe ligjore, dhe mbi 8% prej tyre kanë deklaruar se fëmijët me nevoja të veçanta i pranojnë sepse u vjen keq. Mbi 40% të mësimdhënësve janë deklaruar se fëmijët me nevoja të veçanta janë „pengesë” në klasë.

Mbi 22% të mësimdhënësve deklarojnë se ndihen „jo mirë” me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në klasë dhe 3% e tyre thonë se ndjehen keq kur në klasë kanë fëmijë me nevoja të veçanta. Mbi 3% prej tyre deklarohen se „nuk do t’i pranoja fare”. Ky grup deklarohen edhe në komentet e tyre se nuk di, nuk mundem për shkak të moshës, i pengojnë nxënësit e tjerë, si dhe shumë arsye të tjera (shih tabelën nr. 1 - arsyet për përgjigje negative).

Këto gjetje të mësimdhënësit, janë pothuajse në *harmoni* me gjetjet e të intervistuarve – drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve mbështetës në shkolla. Rreth 54% e drejtorëve deklarojnë se mësimdhënësit hezitojnë për t’i pranuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në klasë dhe se me qejf nuk i pranojnë. Po ashtu, sipas mësimdhënësve mbështetës në shkollat rreth 70% të tyre, deklarojnë se mësimdhënësit „pjesërisht” hezitojnë apo edhe kundërshtojnë pranimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasë dhe shpeshherë krijohen edhe

pakënaqësi apo keqkuptime sa që edhe i detyrojnë mësimdhënësit duke iu „kërcënuar” me legjislacionin në fuqi.

Meqë, pyetjet ishin të shumta dhe përgjigjet dallojnë në shifra, nuk mund të përcaktohen llogaritje të sakta të grupimit të mësimdhënësve në bazë të qëndrimeve, por, analiza e gjetjeve tregon se një grup i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë qëndrime pozitive bindëse për gjithëpërfshirje, ndërsa një grup tjetër shprehin qëndrime negative dhe deklarohen haptas se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, nuk do t'i pranonin në klasë. Por, pjesa më e madhe e mësimdhënësve kanë qëndrime të përziera.

Matja e qëndrimeve të mësimdhënësve është bërë përmes *mënyrës së vetëraportimit*, ku mësimdhënësit kanë pasur mundësinë të përgjigjen sinqerisht në pyetësorin anonim të përpiluar me shkallë të ndryshme të matjes, varësisht nga konteksti i pyetjeve. Po ashtu, shumica e pyetjeve ishin të formuluar në atë formë, me qëllim që të gjurmohen në mënyrë indirekte qëndrimet e mësimdhënësve dhe t'i iket mundësisë së ndjenjës së provokimit. Ndërsa pyetjet e intervistës ishin direkte, në kërkim të përgjigjeve adekuate. Mirëpo, të dhënat tregojnë se shpeshherë disa mësimdhënës, për pyetje të përafërta, kanë dhënë përgjigje të ndryshme që nënkupton se qëndrimet e tyre nuk ishin plotësisht të formuara. Përgjigjet e të tre grupeve të respondentëve, përafërsisht, tregojnë rezultate të njëjta.

Qëndrimet e fuqishme pozitive apo negative të mësimdhënësve tregojnë se njohuritë, mendimet, ndjenjat, perceptimet, e tyre janë të harmonizuara dhe kanë prirje për qasje të caktuar për gjithëpërfshirje. Ndërsa qëndrimet e përziera të mësimdhënësve shprehin mosharmonizim të njohurive dhe mendimeve, me

ndjenjat dhe perceptimet e tyre. Te ky grup i mësimdhënësve, faktorët relevantë mund të ndikojnë në ndryshimin e qëndrimeve. Andaj, për zhvillimin e mëtejshëm të procesit të gjithëpërfshirjes, duhet përmirësuar dhe plotësuar sistemin e mbështetjes, si: ndihmë të vazhdueshme profesionale, programe të nevojshme trajnimi, pajisje me mjete të nevojshme didaktike, zvogëlim të numrit të nxënësve në klasat përfshirëse, motivim të mësimdhënësve përfshirës, etj.

6. PËRFUNDIM

Studimi i qëndrimeve të mësimdhënësve për *zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes në Kosovë*, rezultoi me disa gjetje dhe përfundime karakteristike. Kjo ishte edhe objektiva kryesore e hulumtimit, bashkë me disa rekomandime të dala, të rëndësishme, në të mirë të përmirësimit të mëtejshëm të gjendjes dhe zhvillimit të qasjes gjithëpërfshirëse në shkollat e Kosovës, si faktorë të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të qëndrimeve pozitive të mësimdhënësve.

Përfundimisht, duhet theksuar se, qëndrimet e mësimdhënësve janë faktor i rëndësishëm për zhvillimin e suksesshëm të procesit të gjithëpërfshirjes dhe zbatimit të politikave arsimore të MASHT në Kosovë.

Hipoteza e hulumtimit se të gjithë mësimdhënësit në Kosovë kanë qëndrime negative për arsimin gjithëpërfshirës, nuk është vërtetuar plotësisht. Pas analizës së të dhënave, disa nga përfundimet janë:

- Mësimdhënësit, në bazë të qëndrimeve të tyre për arsimin gjithëpërfshirës mund të ndahen në tri grupe: mësimdhënësit me qëndrime pozitive, mësimdhënësit me qëndrime negative dhe mësimdhënësit me qëndrime të përziera. Pjesa më e madhe e mësimdhënësve i takojnë grupit të fundit;
- Ekzistojnë disa faktorë të cilët ndikojnë në qëndrimet e mësimdhënësve, si: gjinia, mosha dhe përvoja e punës në arsim dhe gjithëpërfshirje, zhvillimi profesional –programet e trajnimit, niveli në të cilin punojnë, vendi, shkolla dhe faktorët mbështetës.
- Grupmosha më e vjetër e mësimdhënësve, sipas treguesve, është grupmoshë me qëndrime më negative për gjithëpërfshirjen, krahasuar me grupmoshën e mesme dhe më të re;
- Edhe pse, rreth 70% e mësimdhënësve kanë marrë pjesë së paku në një program trajnimi për gjithëpërfshirje, vetëm rreth 40% prej tyre mendojnë se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet të përfshihen në klasa të rregullta ndërsa, rreth 30% shprehen se fëmijët me nevoja të veçanta arsimore duhet arsimuar në klasa - shkolla të veçanta;
- Për arsimin gjithëpërfshirës, ekzistojnë dallime në qëndrime edhe ndërmjet mësimdhënësve klasor dhe lëndor. Më

shumë nga mësimdhënësit klasor janë për gjithëpërfshirje, krahasuar me ata lëndor.

- Janë gjetur dallime në qëndrime të mësimdhënësve edhe sipas vendit në të cilin punojnë. Mësimdhënësit nga vendet urbane kanë
- qëndrime më pozitive krahasuar me mësimdhënësit e vendeve rurale;
- Më shumë nga mësimdhënësit e shkolla „gjithëpërfshirëse” kanë qëndrime pozitive për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në klasa të rregullta, krahasuar me mësimdhënësit e shkollave „jogjithëpërfshirëse”.
- Sistemi i mbështetjes nga institucionet relevante, luan rol shumë të rëndësishëm në qëndrimet e mësimdhënësve për gjithëpërfshirje;
- Ndër grupe të marginalizuara, për përfshirje, mësimdhënësit nuk bëjnë dallime shumë të theksuara. Pak më shumë kanë theksuar se preferojnë të punojnë me fëmijë të cilët kanë vështirësi në të nxënë, si dhe fëmijët e komuniteteve;

- Dallimet theksohen më tepër tek llojet dhe nivelet e aftësive të kufizuara. Përqindja më e madhe e mësimitdhënësve preferojnë të punojnë me fëmijë me dëmtime fizike krahasuar me llojet e tjera të dëmtimeve.

Në qëndrimet e mësimitdhënësve, pa dyshim, ndikim të rëndësishëm luajnë edhe cilësitë e personalitetit. Cilësitë e personalitetit nuk kanë qenë objektive e këtij studimi, por mbetet të planifikohet dhe realizohet në ndonjë projekt, në të ardhmen.

7. REKOMANDIME

Meqë, është konstatuar se qëndrimet pozitive të mësimitdhënësve – si prirje për qasje gjithëpërfshirëse, kanë ndikim shumë të rëndësishëm për zbatimin e politikave arsimore dhe zhvillimin e mëtejshëm të procesit të arsimit gjithëpërfshirës, është përgjegjësi e institucioneve relevante që të ndërhyjnë për zhvillimin e procesit dhe të marrin masa të nevojshme për zbatimin e parimit të gjithëpërfshirjes në arsim, duke u ofruar mbështetjen e nevojshme dhe ndikuar në ngritjen e nivelit të qëndrimeve pozitive të mësimitdhënësve.

Nga rezultatet e hulumtimit dhe analiza e tyre, rekomandojmë:

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Të hartojë politika arsimore të zbatueshme për gjithëpërfshirje;

- Të mbështetë programe trajnimi, specifike për gjithëpërfshirje;
- Të rritë dhe fuqizon mbështetjen e nevojshme për mësimdhënësit;
- Të organizojë fushata vetëdijesuese për gjithëpërfshirje në arsim;
- Të përmirësojë kushtet në shkolla.

Për drejtoritë komunale të arsimit:

- Të identifikojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpër shkolla;
- Të identifikojnë dhe mbështetin nevojat e mësimdhënësve për programe specifike trajnimi;
- Të zvogëlojnë numrin e nxënësve në klasa gjithëpërfshirëse;
- Të pajisin shkollat me materiale të nevojshme didaktike;
- Të stimulojnë mësimdhënësit të cilët përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;
- Të mentorojnë dhe monitorojnë procesin e gjithëpërfshirjes;
- Të aktivizojnë ekipet vlerësuese në shërbim të mësimdhënësve;
- Të organizojnë fushata vetëdijesuese për gjithëpërfshirje;
- Të ofrojnë mbështetje të nevojshme, sipas llojit dhe nivelit të aftësive të kufizuara;

- Të punësojnë mësime të mbështetës në shkollat të cilat përfshijnë fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.

Për zyrat e inspektimit:

- Të monitorojnë procesin e gjithëpërfshirjes në shkolla;
- Të monitorojnë qasjen e mësimeve ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore;
- Të identifikojnë dhe raportojnë nevojat për trajnime të mësimeve në klasat përfshirëse;
- Të vlerësojnë mbështetjen e mësimeve nga mësuesit mbështetës dhe mësuesit udhëtues;
- Të vlerësojnë dhe raportojnë infrastrukturën e shkollës në raport me nevojat e nxënësve;
- Të identifikojnë numrin e nxënësve në klasa përfshirëse (sipas udhëzimit administrativ) dhe të ndërmarrin masa në raste të nevojshme.

Për drejtorët e shkollave:

- Të mbështesin mësuesit gjithëpërfshirës;
- Të ofrojnë kushte të nevojshme për punë;
- T'i përfshijnë mësuesit në programe trajnime të nevojshme;
- Të mentorojnë dhe monitorojnë procesin e gjithëpërfshirjes;
- T'i stimulojnë mësuesit gjithëpërfshirës.

**Për mësime dhe mbështetës dhe mësime dhe mbështetës
udhëues:**

- T'i identifikojnë nevojat e mësime dhe mbështetës për mbështetje;
- T'i mbështesin profesionalisht dhe praktikisht mësime dhe mbështetës;
- Të organizojnë trajnime specifike për zhvillim profesional të mësime dhe mbështetësve.

Për prindër:

- Të jenë të hapur me mësime dhe mbështetës;
- Të bashkëpunojnë me mësime dhe mbështetës;
- T'i përkrahin mësime dhe mbështetës.

LITERATURA

- Bandura, A. (2001). Social cognitive theory: An genetic perspective. *Annual Review of Psychology*, 52(1), 1
- Beacham, N., & Rouse, M. (2012). Student teachers' attitudes and beliefs about inclusion and inclusive practice. *Journal of Research In Special Educational Needs*, 12(1), 3-11
- Booth, Toni & Ainscow (përshtatur nga Dr. Naser Zabeli, MA Lulavere Behluli), *Indeksi për gjithëpërfshirje, Save the Children*, 2011, Prishtinë
- Dragoti, Edmond.(2007), *Psikologjia Sociale*, Toena, Tiranë
- Emam, M. M., & Farrell, P. (2009) Tensions experienced by teachers and their views of support for pupils with autism spectrum disorders in mainstream schools. *European Journal of Special Needs Education*, 24(4), 407-422
- Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, (gusht 2011), MASHT, Prishtinë
- Knight, B. A. (1999). Towards inclusion of students with special educational needs in the regular classroom. *Support for Learning*, 14(1), 3-7

- Ligji për Arsimin Parauniversitar, (2011), MASHT, Prishtinë
- McGregor, E., & Elaine, C. (2001). The attitudes of teachers in Scotland to the integrations of children with autism into mainstream schools. *SAGE Publications and The National Autistic Society*, 5(2), 189-207
- Morris, G.C. & Maisto, A. A. (2008). *PSIKOLOGJIA shkenca e proceseve mendore dhe sjelljes njerëzore*, CDE, Tiranë
- Myers G. David. Socialpsikologjia, përkth. Enian Çela. (2003), Uegen, Tiranë
- Pettijohn, F. Terry. *Psikologjia: një hyrje koncize*. Tiranë: përkth. Virgjil Muçi, (1996), Lilo, bot.2
- Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2010-2015, (2011), MASHT, Prishtinë
- Ryan, T. G., (2009). Inclusive attitudes: A pre-service analysis. *Journal of Research in Special Educational Needs*, 9(3), 180-187
- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017. (2007), MASHT, Prishtinë
- Westwood, P., & Graham, L. (2003). Inclusion of students with special needs: benefits and obstacles perceived by teachers in New South Wales and South Australia. *Australian Journal of Learning Disabilities.*, 8(1), 3-15

Burime ON–LINE

- Avramidis, E. & Norwich, B. , Teachers' attitudes towards integration / inclusion: a review of the literature. *European Journal of Special Needs Education* . Vol. 17, No. 2 (2002), pp. 129–147 (janar 2015)
- Chopra, Ritta.: Factor influencing Elementary School teacher's attitude towards inclusive education, *British Educational Research Association Annual Conference*,. Edinburgh, 2008.<http://www.leeds.ac.uk/educol/documents/174842.pdf> (shkurt, 2015)
- Jennifer M.Cassady, Teachers' Attitudes Toward the Inclusion of Students with Autism and Emotional Behavioral, *Electronic Journal for Inclusive* ,Vol. 2, No. 7 (Winter/Spring2011)<http://corescholar.libraries.wright.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1127&context=ejie>(shkurt,2015)
- Subban,P. & Sharma,U., Understanding Educator Attitudes Toward the Implementation of Inclusive Education, *Disability Studies Quarterly Spring 2005, Volume 25, No. 2*, www.dsqsds.org (mars, 2015)
- Walker J.T., , "Attitudes and Inclusion: An Examination of Teachers' Attitudes Toward Including Students with Disabilities"(2012). *Dissertations*. Paper 401.http://ecommons.luc.edu/luc_diss/401 (mars,2015)

- www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosove.s.pdf

Udhëzime administrative

- Udhëzim Administrativ: Nr. 18/2013 Përdorimi i Planit Individual të Arsimit
- Udhëzim Administrativ: Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës – nxënës
- Udhëzim Administrativ: Nr.23/2013 Qendrat Burimore
- Udhëzim Administrativ: nr. 24/2014 Shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve

Shtojcë

Lista e shkollave të përfshira në hulumtim

Shkolla	Vendi	Komuna
A.Z. Çajupi	Mitrovicë	Mitrovicë
Ahmet Delija	Skënderaj	Skënderaj
Ahmet Hoxha	Ferizaj	Ferizaj
Ali kelmendi	Vushtrri	Vushtrri
Emin Duraku	Davidoc	Shtime
Fan.S.Noli	Kamenicë	Kamenicë
Halil Bajraktari	Drenas	Drenas
Haradin Bajrami	Magure	Lipjan
Ibrahim Fehmiu	Arbanë	Prizren
Ibrahim Rugova	Obiliq	Obiliq
Ibrahim Rugova	Podujevë	Podujevë
Ibrahim Uruqi	Bresalc	Gjilan
Ilaz Thaçi	Hani i Elezit	Hani i Elezit
Isa Boletini	Rahovec	Rahovec
Ismail Qemali	Prishtinë	Prishtinë
Ismet Rraci	Klinë	Klinë
Mihail Grameno	Fushë Kosovë	Fushë Kosovë
Motrat Qiriazhi	Prizren	Prizren

Migjeni	Mitrovicë	Mitrovicë
Minatori	Novobërdë	Novobërdë
Nazmi Zhegrova	Stanoc i p.	Vushtrri
Ramiz Sadiku	Pejë	Pejë
Rexhep Elmazi	Gjilan	Gjilan
Shkëndija	Suharekë	Suharekë
Trepça	Banjë	Istog
Zekirja Rexha	Gjakovë	Gjakovë
Zef Lush Marku	Brekoc	Gjakovë

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja NTSH “Rilindja” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.09(496.51)

Reçica-Havolli, Sahare

Qëndrimet e mësimdhënësve për zbatimin e filozofisë së gjithëpërfshirjes në institucionet arsimore në Kosovë / Sahare Reçica-Havolli. - Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. - 104 f.: ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Literatura: f. 98-101

ISBN 978-9951-591-32-4

ISBN 978-9951-591-32-4



9 789951 591324